

BAHRI BECI

FLASIM DHE HARTOJMË NJOHIM GJUHËN

GJUHA SHQIPE 4
për klasën e katërt të shkollës fillore nëntëvjeçare
LIBRI I MËSUESIT



Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore
PODGORICË

Dr. BAHRI BECI

FLASIM DHE HARTOJMË NJOHIM GJUHËN

GJUHA SHQIPE 4

për klasën e katërt të shkollës fillore nëntëvjeçare

LIBRI I MËSUESIT

ГОВОРИМО И САСТАВЉАМО УПОЗНАЈЕМО ЈЕЗИК

АЛБАНСКИ ЈЕЗИК 4

за четврти разред деветогодишње основне школе

ПРИРУЧНИК

Botuesi: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore; Podgoricë

*Kryeredaktore dhe
redaktore përgjegjëse:* Natasha Zhivković

Redaktor: Zarija Brajović

Recensentë: Prof. dr. Mark Camaj
Prof. dr. Artan Haxhi
Qamil Maraj, mësues i lëndës mësimore
Prof. dr. Fatmir Vadahi, pedagog
Prof. dr. Vehbi Hoti, psikolog

Ilustrimi: Simon Vučković

Disenjoja dhe faqosja: Sasha Protiq

Korrektor: Rrok Gjolaj

Redaktor teknik: Rajko Radulović

Për botuesin: Nebojsa Dragović

Shtypur në Studio "Mouse"; Podgoricë

Tirazhi: 50

ISBN: 978–86–303–1320–2

Këshilli i Arsimit të Përgjithshëm, me vendimin nr. 04–3–183 të datës 29. 08. 2008, e ka miratuar këtë komplet të tekstit mësimor për përdhorim në shkollat fillore nëntëvjeçare.

PASQYRA E LËNDËS

STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E TEKSTIT MËSIMOR4

ECURIA METODIKE PËR REALIZIMIN E QËLLIMEVE7

Pjesa e parë

Zgjerohet njohuritë tona	10
Gjuha letrare.....	12
Shkronja e madhe	14
Lutemi dhe urojmë	16
Llojet e fjalive	17
Fjalitë pohore dhe mohore	18
Zanoret dhe bashkëtingëlloret.....	19
Ndarja e fjalëve në fund të rreshtit.....	20

Pjesa e dytë

Shkruajmë letra dhe kartolina	24
Emërtimet e rrugëve dhe të shesheve.....	25
Shkrimi i datave.....	26
Ylberi	27
Mbiemrat	28
Foljet.....	29
<i>Nuk, s' + folje</i>	30
Përemrat vektorë.....	31

Pjesa e tretë

Zanatet ose mjeshtritë	34
Kryefjala	35
Kallëzuesi.....	36
Fjala e zgjeruar	37
Plotësojmë formularë.....	38
Emërtimet e festave.....	39
Zanorja e dhe bashkëtingëlloret <i>dh, ll</i>	40

Pjesa e katërt

Çfarë është gjuha?.....	44
Gjuha amtare.....	45
Kuptimet e fjalës	46
Gjuha e huaja	47
Pse i mësojmë gjuhët e huaja?	48
Në restorant.....	48
Zgjidhjet e ushtrimeve të Flettores së punës.....	49-57

STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E TEKSTIT MËSIMOR

Teksti mësimor *Flasim dhe hartojmë Njohim gjuhë 4* është vazhdim i drejtpërdrejtë i Teksteve mësimore për klasën e 1^{-rë}, të 2^{-të} dhe të 3^{-të} në synimet e tij për ta përvetësuar mësimin e gjuhës amtare përmes të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit. Ndryshon prej tyre në strukturë për shkak të ndryshimit të vetë përmbajtjes së mësimin të gjuhës amtare në klasën e katërt, që shënon edhe kalimin nga cikli i parë në ciklin e dytë që ka si synim rritjen e mëtejshme të aftësive për të folur, për të lexuar dhe për të shkruar. Njohja e veçorive të sistemit të gjuhës letrare shqipe, në këtë cikël zë një vend më të dukshëm se në ciklin e parë, por edhe në këtë cikël një gjë e tillë konceptohet si praktikë gjuhësore. Kjo diktohet nga veçoritë e zhvillimit mendor dhe psikik të fëmijëve të kësaj moshe. Pra, edhe në këtë nivel shkollimi mësimi i gjuhës amtare është praktikë gjuhësore.

Teksti mësimor ka katër pjesë themelore që përcaktohen nga problematika kryesore e trajtuar në secilën prej tyre.

1. Pjesa e parë
2. Pjesa e dytë
3. Pjesa e tretë
4. Pjesa e katërt

Pjesa e parë

Tematika e teksteve të shkruara të kësaj pjesë të parë synon të zgjerojë njohuritë e nxënësve me të dhëna të thjeshta gjeografike, historike e kulturore që besojmë se zgjojnë interesin e fëmijëve (*Ishulli "Ada", "Veshjet popullore", "Babai i gjuhës shqipe", "Mali i Zi", "Si formohen tingujt"*), ose që ndikojnë në edukimin e tyre ("*Tri gëzimet*"), si edhe t'i aftësojë ato që të analizojnë kompozicionin e teksteve të shkruara, të dallojnë veçoritë e paragrafit, të luten dhe të urojnë. Në këtë pjesë të parë, pra, nxënësit njihen me tipa të ndryshme tekstesh joletrare dhe ushtrohen të hartojnë vetë tekste të tilla.

Mësimet e tjera të kësaj pjesë u kushtohen veçorive të gjuhës në përgjithësi, sistemit gjuhësor dhe drejtshkrimin (*Gjuha letrare, Shkronja e madhe, Llojet e fjalive, Fjalitë pohore dhe mohore, Zanoret dhe bashkëtingëlloret*)

Përmbajtja e njohurive për sistemin gjuhësor paraqitet si vazhdim e thellim i njohurive të fituara në ciklin e parë.

Pjesa e dytë

Në këtë pjesë të dytë, nxënësit do të njihen me tipa të ndryshëm tekstesh joletrare po edhe ndonjë letrar dhe do të ushtrohen të hartojnë vetë tekste të tilla. Tematika e kësaj pjesë të dytë lidhet me shkrimin e letrave dhe të kartolinave, po edhe me dukuri të natyrës dhe përshkrime vendesh ("*Tori në postë", "I dashur Gjergj", Letra, Ylberi, Isak Njutoni, Podgorica, Çfarë është moti?*).

Mësimet e tjera të kësaj pjesë u kushtohen njohurive për veçoritë e sistemit gjuhësor (*Emërtimet e rrugëve dhe të shesheve, Shkrimi i datave, Mbiemrat, Foljet, Nuk, s' + folje, Përemrat vectorë*), po edhe këto trajtohen në masën që lejon mosha e fëmijëve të klasës së katërt dhe në pajtim me veçoritë e zhvillimit mendor dhe psikologjik të tyre.

Në këtë moshë, por as më vonë, nuk duhet të kërkojmë nga nxënësit që të riprodhojnë në mënyrë mekanike rregullat gramatikore, por që të aftësohen për t'i dalluar kategoritë gramatikore, për të shpjeguar se përse shërbejnë dhe për t'i përdorur drejtë.

Pjesa e tretë

Pjesa e tretë përmbledh tekste joartistike që flasin për zanate të ndryshme (*Argjendaria, Cirku "Medrano", Zbutësi i arinjve, .*). Në këtë pjesë, nxënësit do të mësojnë gjithashtu se çfarë është formulari dhe të plotësojnë vetë formularë.

Mësimet e tjera të kësaj pjesë, në përputhje me kërkesat e programit, u kushtohen njohurive për veçoritë e sistemit gjuhësor.

Përmbajtja e njohurive për sistemin gjuhësor në këtë pjesë është vazhdim i njohurive të fituara në pjesën e parë dhe të dytë (*kryefjala, kallëzuesi, Fjalë e zgjeruar, Emërtimet e festave, Zanorje ë dhe bashkëtingëlloret ll/dh*). Njohuritë që jepen edhe në këtë pjesë dhe mënyra e trajtimit të tyre edhe në këtë pjesë është praktikë gjuhësore. Ajo është në pajtim me veçoritë e zhvillimit mendor dhe psikologjik të fëmijëve të kësaj moshe.

Pjesa e katërt

Pjesa e katërt u kushtohet problemeve që lidhen me gjuhën si dukuri shoqërore dhe si mjet komunikimi: *Çfarë është gjuha, Gjuha amtare, Kuptimet e fjalës, Gjuhët e huaja, Pse i mësojmë gjuhët e huaja? Në restaurant.*

Edhe në këtë pjesë ka tekste joletrare si: *Çfarë është gjuha?, Nga belbëzimet tek të folurit, Gjuha amtare, Kongresi i Alfabetit, Gjuha e huaj,* që flasin për aspekte të ndryshme që lidhen me fenomenin gjuhësor.

Gjatë zgjedhjes së teksteve të shkruara kemi pasur parasysh që të zgjedhim tekste me tematikë të përshtatshme për moshën e nxënësve, për aftësitë e tyre njohëse dhe interesante për moshën e tyre. Nëse tekstet e zgjedhura ju i gjykoni se duhen redaktuar nga kjo ose ajo pikëpamje, ju mund ta bëni këtë, por duhet të ruani të dhënat. Tekstet janë nxjerrë nga enciklopeditë për fëmijë, nga interneti etj. Kur e kemi gjykuar të nevojshme, tekstet i kemi modifikuar dhe përshtatur.

Pas çdo teksti të shkruar vijne pyetjet që ju mundësojnë të punoni për të zhvilluar më tej tek fëmijët aftësinë për të analizuar dhe për të kuptuar tekstet joletrare. E rëndësishme gjatë analizës së teksteve është që nxënësit/et jo vetëm të kuptojnë përmbajtjen ose idenë kryesore të tekstit, por të dinë edhe ta ndajnë tekstin në pjesët e tij përbërëse dhe të kuptojnë lidhjen që ekziston ndërmjet tyre.

Qëllimi përfundimtar i tërë punës me leximin është që nxënësit të arrijnë ta kuptojnë mirë tekstin e shkruar dhe ta mbajnë mend. Para fillimit të analizës së një teksti joletrar duhet të pyesim nxënësit, se çfarë dinë ata për problemin që trajtohet në tekstin që do të lexohet. Mund të shkruani në tabelë ato që thonë fëmijët. Pas kësaj mund t'i grupojmë pohimet e tyre sipas një kriteri logjik në disa të dhëna, kategori ose aspekte themelore.

Kjo u jep mundësi nxënësve të dallojnë të dhënat kryesore nga ato jo kryesore dhe t'i rendisin ato në mënyrë logjike, çka lehtëson kuptimin dhe mbajtjen mend të tekstit në përgjithësi.

Për ta bërë mësimin interesant dhe për ta lidhur më mirë me aktualitetin, rekomandohet që mësuesi, sipas vlerësimeve të tij, ta pasurojë orën e mësimimit me tekste nga aktualiteti me interes për fëmijët e kësaj moshe.

Punët me shkrim janë një aspekt tjetër i rëndësishëm i procesit mësimor në klasën e katërt. Ato duhen kuptuar si një mjet komunikimi i fëmijës me të tjerët. Prandaj, është e rëndësishme që t'u mundësohet fëmijëve që ta përdorin dhe përsosin gradualisht këtë mjet shumë të rëndësishëm të komunikimit. Duhet pasur parasysh se fëmijët nuk e kanë të lehtë të shkruajnë për një tematikë të caktuar, sidomos kur nuk e kanë përjetuar atë. Prandaj, është mirë që ata të shkruajnë për gjëra që i njohin ose që i kanë parë, për gjëra që u kanë bërë përshtypje atyre ose shokëve të tyre. Në këtë rast, ata do të shkruajnë duke u nisur nga imagjinata dhe ndjeshmëria e tyre.

Mësuesi ka për detyrë t'i nxitë dhe inkurajojë vazhdimisht nxënësit në këtë drejtim. Është mirë që nxënësit ta zgjedhin vetë temën për të cilën do të shkruajnë. Është një rast ky për të provuar e verifikuar vetveten, aftësitë e veta për të dhënë një përmbajtje të caktuar, për të parashtruar ide, për të shkruar me një gjuhë të saktë nga ana gramatikore dhe drejtshkrimore, për

t'u paraqitur para një opinioni të caktuar shoqëror (shokëve të klasës, ose më gjerë. Në këtë mënyrë, u krijojmë mundësi fëmijëve që, në këtë moshë, të shkruajnë për publikun, pra, të përgatiten si krijues.

Kjo është një punë që do të vazhdojë gjatë gjithë shkollimit të nxënësve, por bazat e këtij formimi hidhen që në këtë moshë, prandaj kjo punë duhet vlerësuar dhe mbështetur me të gjitha mundësitë.

Në këtë mënyrë, ju do të edukoni gradualisht tek fëmijët dashurinë për shkrimin dhe do t'i aftësoni ta kuptojnë atë si burim kënaqësie dhe si mjet komunikimi.

Duhet të bisedoni me fëmijët para se të fillojnë të shkruajnë, t'u bëni pyetje për përmbajtjen e asaj që do të shkruajnë, për të dhënat kryesore që do të paraqesin, për zhvillimin e ngjarjeve etj. Edhe pas variantit të parë të shkrimit, ju duhet të bisedoni me nxënësit, t'u ndihmoni që të gjejnë mungesat, gabimet dhe t'i ndreqin ato vetë.

Ju do të hartoni vetë testet e shkruara që do të zhvillohen në fund të çdo pjese dhe në përfundim të lëndës për verifikimin e njohurive të fituara dhe të shkallës së përvetësimit. Për testet mund të udhëhiqeni nga tipat e ushtrimeve të parashtruara në Fletoren e punës, por jeni të lirë të shkoni edhe më tutje në vartësi të veçorive të përvetësimit të lëndës nga nxënësit e klasës suaj. Po kështu, është e drejta e juaj, që të përcaktoni përmbajtjen dhe mënyrën e realizimit të një projekti të caktuar në përputhje me tematikën e mësimave dhe interesin e nxënësve. Për këtë duhet të përcaktohet tema, grupet e punës dhe veprimtaritë për secilin prej tyre.

Fletorja e punës është konceptuar në mënyrë të tillë që, pas punës me Tekstin mësimor, nxënësit t'i thellojnë më shumë njohuritë e fituara në të dhe të zhvillojnë të menduarit e vet logjik dhe krijues. Jemi përpjekur të japim tipa të ndryshëm detyrash, tekste të reja, për të mundësuar punën krijuese dhe të pavarur në arritjen e objektivave të parashikuara me Program. Meqë me këtë klasë fillon cikli i dytë i shkollës nëntëvjeçare, programi është më kërkues, tërësia e pyetjeve parasheh kërkesa minimale dhe mesatare, ndërsa detyrat janë konceptuar nga ato të lehtë deri tek ato të vështirat.

Për t'u shfrytëzuar në mënyrë sa më funksionale Teksti mësimor dhe Fletorja e punës, është hartuar edhe Manuali për mësuesin. Kjo pjesë e kompletit mësimor paraqet mënyrën e realizimit të përmbajtjes mësimore.

Në të vërtetë, ne mendojmë se i duhet lënë mësues-it/-es e drejta për të vendosur përfundimisht për realizimin konkret metodik të çdo ore mësimi në përputhje me veçoritë e klasës ku zhvillon mësimin dhe të stilittë të tij të punës.

PROPOZIM PËR NDARJEN ORËVE

Pjesët	Numri i orëve
Pjesa e parë	17
Pjesa e dytë	14
Pjesa e tretë	15
Pjesa e katërt	11
Testet dhe qortimet	6
Punë me projekt	3

64

**ECURIA METODIKE PËR REALIZIMIN
E QËLLIMEVE**

Pjesa e parë

11

Zgjerohmë njohuritë tona

Qëllimi: të lexojnë dhe kuptojnë nxënësit tekstet joletrare, të dallojnë kompozicionin e tekstit (hyrjen, zhvillimin, përfundimin, paragrafin).

Mjetet e nevojshme mësimore: albumi me fotografi nga zona e bregut të Bunës, në përgjithësi, dhe nga ishulli Ada, në veçanti.

Ora e parë

Veprimtaritë e mësues-it/-es:

- pyet nxënësit se çfarë dinë për zonën përreth Ulqinit, a kanë qenë ndonjëherë atje, çfarë u ka bërë përshtypje ose u ka pëlqyer më shumë etj.
- propozon të shohin albumin dhe të flasin për objektet e ndryshme që kanë parë në atë zonë;
- pyet për ishulli “Ada”, nëse e kanë vizituar dhe nëse dinë diçka për të;
- u kërkon të lexojnë tekstin përkatës në Librin e nxënësit.
- bën pyetjet: *Për çfarë flitet në këtë tekst? Kur është formuar ishulli Ada? Ku është formuar? Si është formuar?*
- pasi analizohet përmbajtja e tekstit përmes pyetjeve të mësipërme, vijohet me grupin e dytë të pyetjeve: *Pse është shënuar teksti me ngjyra? Çfarë të dhënash jepen në pjesën e tekstit me shkronja të kuqe? Çfarë të dhënash jepen në pjesën e tekstit me shkronja të zezë? Pse fjalitë e fundit janë veçuar nga pjesa tjetër e tekstit? Cila pjesë e tekstit është më e madhe? Përse? Nga sa pjesë përbëhet ajo? Kur shkruani për një temë të caktuar, a ka ndonjë rregull në renditjen e pjesëve të një teksti?*
- nxirren përfundimet, se të shkruash për një temë do të thotë të paraqesësh mendimet e tua për të, që të kesh kujdes që gjatë shkrimit t’i radhitësh drejtë pjesët e tekstit, se kjo radhitje e drejtë e pjesëve të tekstit të shkruar nënkupton se teksti duhet të ketë: *hyrjen, zhvillimin dhe përfundimin*, se hyrja është pjesa e parë e tekstit ku parashtrohet tema e trajtuar që duhet të zgjojë interesimin e lexuesit, se zhvillimi është pjesa më e rëndësishme dhe më e gjatë e tekstit të shkruar ku duhet të jepen përgjigjet për temën e trajtuar, se përfundimi është pjesa e fundit e tekstit të shkruar ku jepet qëndrimi përfundimtar lidhur me temën;
- kërkon nga nxënësit të zhvillojnë ushtrimet nr. 1-2 në Fletoren e punës.

Ora e dytë

Mjetet e nevojshme mësimore: një album me veshje shqiptare.

Veprimtaritë e mësues-it/-es:

- pyet nxënësit se çfarë dinë për veshjet popullore shqiptare, a kanë në familjet e tyre veshje të vjetra ose tradicionale shqiptare për burra apo për gra dhe u kërkon t’i përshkruajnë ato;
- propozon të shohin albumin dhe të flasin për veshjet që shohin, t’i krahasojnë me veshjet e krahinës së tyre, sigurisht në masën që lejon mosha e tyre;
- fton nxënësit të lexojnë tekstin “Veshjet popullore” dhe organizon diskutimin e tij;
- bën pyetjet: *Sa pjesë ka ky tekst? Përse flitet në pjesën e parë? Përse flitet në pjesën e dytë? Si quhen pjesët e një teksti që kanë një ide të përbashkët?*
- nxirren përfundimet se pjesa e tekstit që shënohet me kalimin në një rresht të ri, të futur pak brenda është paragrafi, se çdo paragraf ka një *ide* që i lidh të gjitha fjalitë e tij.
- kërkon nga nxënësit të zhvillojnë ushtrimet nr.3-4 në Fletoren e punës.

Ora e tretë

Veprimtaritë e mësues-it/-es:

- kërkon nga nxënësit të thonë se ç'do të thotë të shkruash për një temë të caktuar dhe çfarë duhet të kenë parasysh kur shkruajnë për atë temë; ç'është *hyrja, zhvillimi dhe përfundimi*.
- pyet për pushimet e verës: ku kanë qenë, kur kanë qenë, çfarë kanë bërë dhe a janë kënaqur gjatë pushimeve;
- ndihmon nxënësit që të hartojnë skemën apo planin e shkrimit dhe realizimin e tij në tekst duke pasur parasysh tri pjesët kryesore të tekstit: *hyrjen, zhvillimin, përfundimin*;
- organizon diskutimin, korrigjimin dhe vlerësimin e teksteve të shkruara.

Vërejtjet e mësues-it/-es :

Gjuha letrare

Qëllimi: të kuptojnë nxënësit se në shkollë dhe në zyra flitet gjuha letrare ose zyrtare, se fjalët joletrare duhen mënjeluar nga përdorimi si në gjuhën e folur ashtu edhe në gjuhën e shkruar letrare, të kuptojnë se në gjuhën letrare ka disa rregulla që duhen zbatuar, kur flasim dhe kur shkruajmë.

Mjetet e nevojshme mësimore: regjistrimi në magnetofon i dy bisedave një në gjuhën letrare dhe i një bisede në gjuhën jo letrare; fotografi ose ilustrime të tjera nga jeta dhe vepra e K. Kristoforidhit.

Ora e parë

Veprimtaritë e mësues-it/-es:

- fillimisht pyet fëmijët: *A flasim njësoj në shtëpi dhe në shkollë? Si quhet gjuha që flasim në shkollë? Ku flitet gjuha letrare?* etj.
- nxirren përfundimet, se në shkollë flasim dhe shkruajmë në gjuhën letrare, se gjuha letrare përdoret jo vetëm në shkollë, por edhe në institucionet shtetërore etj.
- kërkon nga nxënësit që të dëgjojnë dy regjistrimet e bëra në magnetofon, një në gjuhën letrare dhe një në gjuhën joletrare;
- organizon diskutimin rreth regjistrimeve, kërkon të dallohen fjalët joletrare të përdorura në regjistrimin joletrar;
- organizon diskutimin për fjalët letrare që mund të përdoren në vend të fjalëve joletrare;
- kërkon të lexohen në Librin e nxënësit tekstet “Në shkollë” dhe “Në shtëpi”;
- bën pyetjet: *Kush flet në bisedën e parë? Me ke flet? Kush flet në bisedën e dytë? A vini re ndryshime në këto dy biseda? Pse ndryshojnë ato? Cilat fjalë nuk janë letrare në bisedën e dytë? Çfarë kuptimi kanë fjalët **nadje**, **sahat**? Si mund të thuhen ndryshe? Çfarë fjalësh janë ato? Po ju dhe moshatarët tuaj, a përdorni fjalë si këto? Kërkohej që fjalët joletrare të zëvendësohen me fjalë letrare. Vijohet me pyetjen: *Po fjalët **fëmitë**, **ashtë**, a janë shkruar si duhet në gjuhën letrare?**
- nxirren përfundimet, se në shkollë dhe në institucionet shtetërore flitet në gjuhën letrare, se fjalët: *nadja mirë, fëmit, ashtë, sahati, çohuni* nuk janë letrare ose nuk janë përdorur sipas rregullave të gjuhës letrare, se në gjuhën letrare fjalët duhet të përdoren në përputhje me disa rregulla të caktuara, se ato fjalë që nuk janë në përputhje me rregullat e gjuhës letrare janë joletrare, se fjalët që nuk i përgjigjen rregullave të gjuhës letrare duhet të ndreqen;
- kërkon të zhvillohen ushtrimet nr.1-2 në Fletoren e punës

Ora e dytë

Veprimtaritë e mësues-it/-es:

- pyet nxënësit, a kanë dëgjuar të flitet për Konstandin Kristoforidhin, për jetën dhe për veprën e tij;
- tregon portretin e K. Kristoforidhit dhe vazhdon bisedën duke u treguar për punën e tij për abetaren, alfabetin, gramatikën dhe fjalorin e gjuhës shqipe, sigurisht në masën që është e përshtatshme për moshën e fëmijëve të klasës së katërt dhe mundësisht përmes fotosh dhe objektesh si ilustrime konkrete;
- fton nxënësit të lexojnë tekstin përkatës në Librin e nxënësit;
- bën pyetjet: *Për çfarë flitet në këtë tekst? Si ishte Kristoforidhi? Pse shkante ai në qytete dhe fshatra? Si vepronte ai për të grumbulluar fjalët e rralla të gjuhës shqipe? Përse quhet Kristoforidhi babai i gjuhës shqipe?*
- nxirret përfundimi se Kristoforidhi quhet babai i gjuhës shqipe, sepse gjithë jetën i ka kështu gjuhës shqipe, studimit dhe zhvillimit të saj;
- vijon me pyetjet: *Si thuhen tek ju fjalët letrare **vatër**, **fshat**, **fshatare**, **vezë**, **zuri të thërrasë**,*

të holla? Cila nga këto fjalë përdoret në krahinën tuaj: **qoshja, qoshku, këndi, cepi?** A kanë dallime në kuptim fjalët **qoshja, qoshku, këndi, cepi?**;

- nxirren përfundimet se fjalët **vatër, fshat, fshatare, vezë, zuri të thërresë, të holla** në krahinën e tyre thuhet **vatër, katund, katundare, vë, filloi me thirrë, páre** dhe se kur flasin ose shkruajnë duhet të përdorin fjalët **vatër, fshat, fshatare, vezë, zuri të thërresë, të holla** ose **pára**;
- kërkon të zhvillohen ushtrimet nr. 3-4 në Fletoren e punës.

Vërejtjet e mësues-it/-es :

Shkronja e madhe

Qëllimi: të përvetësojnë dhe të zbatojnë nxënësit rregullat drejtshkrimore lidhur me përdorimin e shkronjës së madhe në fillim të emrave të përveçëm që shënojnë shtete, qytete, male, fshatra dhe lumenj.

Mjetet e nevojshme mësimore: pllakati me fjali që përmbajnë emra shtetesh dhe emra qytetesh, malesh, fshatrash, lumenjsh të Malit të Zi si edhe një hartë e Malit të Zi dhe një album me fotografi nga Mali i Zi.

Ora e parë

Veprimtaritë e mësues-it/-es:

- pyet se çfarë kemi mësuar vitet e kaluara për emrat e përveçëm dhe drejtshkrimin e tyre, duke kërkuar të shkruhen në dërrasë të zezë emra të përveçëm njerëzish dhe kafshësh;
- nxirret përfundimi se emrat e përveçëm të njerëzve dhe të kafshëve shkruhen me shkronjë të madhe në fillim;
- kërkon nga nxënësit të thonë disa emra shtetesh, qytetesh, malesh ose lumenjsh dhe i fton të shkruajnë në dërrasë të zezë disa prej tyre;
- organizon diskutimin për drejtshkrimin e tyre duke iu referuar njohurive që kanë fituar nxënësit në klasë të tretë për emrat e përveçëm;
- kërkon të shohin pllakatin që ka përgatitur me fjali që përmbajnë emra shtetesh dhe emra qytetesh, fshatrash, malesh, lumenjsh nga Mali i Zi;
- bën pyetje si këto: *Çfarë emrash janë, të përveçëm apo të përgjithshëm? Si janë shkruar ata? Përse janë shkruar me shkronjë të madhe në fillim?*;
- nxirret përfundimi se emrat shteteve, qyteteve, fshatrave, maleve dhe lumenjve shkruhen me shkronjë të madhe në fillim;
- kërkon të shohin në Librin e nxënësit tabelën me emra të përveçëm shtetesh, qytetesh etj.;
- bën pyetjet: *Çfarë shënojnë emrat Slloveni, Kroaci, Shqipëri, Mali i Zi? Çfarë shënojnë emrat Podgoricë, Nikshiq, Tiranë, Shkodër? Çfarë shënojnë emrat Vojnik, Lloçë, Korab, Tarabosh? Çfarë shënojnë emrat Moraçë, Vjosë, Zeta, Shkumbin? Çfarë emrash janë emrat e shteteve, qyteteve, maleve dhe lumenjve? Çfarë shkronje kanë në fillim emrat e përveçëm të shteteve, qyteteve, maleve dhe lumenjve?*
- nxirret përfundimi se emrat e përveçëm të shteteve, qyteteve, fshatrave, maleve dhe lumenjve shkruhen me shkronjë të madhe në fillim;
- kërkon të shohin tabelën me emra shtetesh, qytetesh etj. të përbërë nga dy fjale: *Mali i Zi, Bjello Polje* etj.;
- bën pyetjet: *Çfarë shënojnë emrat e secilës kolonë? Çfarë dallimi kanë këto emra me emrat e tabelës së parë? Si janë shkruar emrat e shteteve, qyteteve, fshatrave, maleve dhe lumenjve të përbërë nga dy shkronja?*
- nxirret përfundimi se emrat e shteteve, qyteteve, fshatrave, maleve, lumenjve, kur përbëhen nga dy ose më shumë fjale, secila fjale duhet të fillojë me shkronjë të madhe;

Ora e dytë

Veprimtaritë e mësues-it/-es:

- kërkon nga nxënësit të lexojnë në Librin e nxënësit tekstin “Mali i Zi”;
- bën pyetjet: *Çfarë shënojnë emrat Mali i Zi, Shqipëri, Kosovë, Serbi, Bosnje Hercegovinë, Kroaci? Çfarë shënojnë emrat Cetinjë, Nikshiq? Çfarë shënojnë emrat Durmitor, Kollatë? Çfarë shënojnë emrat Zeta, Moraça, Limi, Buna? Çfarë shkronje kanë në fillim emrat e shteteve, qyteteve, maleve dhe lumenjve?*
- ritheksohet përfundimi se emrat e shteteve, qyteteve, maleve dhe lumenjve shkruhen me shkronjë të madhe në fillim (*Mali i Zi, Cetinjë, Durmitor, Moraçë*);
- kërkon të zhvillohen ushtrimet nr.1-5 në Fletoren e punës.

Shënim: mësuesi/-ja mund t'u japë nxënësve si detyrë shtëpie një ose dy ushtrime nga Fletorja e punës. Kjo gjë varet nga koha që ka në dispozicion, nga karakteri dhe nga përmasa e ushtrimeve. Ky parim duhet zbatuar në përgjithësi në dhënien ose jo të detyrave të shtëpisë, të cilat mund të jenë nga Fletorja e punës ose të hartuara nga vetë mësuesi.

Vërejtjet e mësues-it/-es :

Lutemi dhe urojmë

Qëllimi: të lexojnë dhe kuptojnë nxënësit tekstet joletrare, të dallojnë lutjen dhe urimin, si edhe të aftësohen që të shkruajnë dhe të formulojnë vetë lutje dhe urime.

Mjetet e nevojshme mësimore: dy lloje tekstesh të zgjedhura nga mësuesi, të cilët përmbajnë lutje dhe urime të regjistruar në magnetofon.

Ora e parë

Veprimtaritë e mësues-it/-es:

- kërkon nga nxënësit që të flasin për të luturit, i pyet a i kanë kërkuar dikujt diçka, kujt ia kanë kërkuar, çfarë i kanë kërkuar, si ia kanë kërkuar;
- dëgjohe teksti i regjistruar ku paraqitet një lutje;
- organizon analizën e tekstit të regjistruar dhe arrihet në përfundimin se kemi të bëjmë me një *lutje*;
- kërkon që të lexohet në Librin e nxënësit teksti në të cilin Andi i lutet komshiut për të folur me babin e vet në telefonin e tyre;
- bën pyetjet: *Kush flet? Me kë flet? Çfarë i kërkon Andi xhaxhi Metit? Po ai si i përgjigjet? Çfarë vini re në gjuhën e Andit?*
- nxirren përfundimet se kur i kërkojmë dikujt diçka me të mirë, themi se i *lutemi*, se kur i lutemi dikujt për diçka, duhet të kemi parasysh me kë flasim dhe të përdorim fjalët: *më falni, ju lutem, a ka mundësi, faleminderit* etj.;
- kërkon të zhvillohen ushtrimet nr.1-2 në Fletoren e punës.

Ora e dytë

Veprimtaritë e mësues-it/-es:

- kërkon nga nxënësit që të flasin për urimet, i pyet a kanë marrë urime, me çfarë rasti, kush ua ka dërguar; nëse kanë dërguar urime, kujt ia kanë dërguar dhe me çfarë rasti;
- kërkon të lexojnë në Librin e nxënësit dy tekstet drejtuar Andit për ditëlindje;
- bën pyetjet: *Kush i ka shkruar këto dy tekste? Kujt i drejtohen? Me ç'rast janë shkruar? Çfarë janë këto dy tekste? Cili prej tyre do ta gëzojë më shumë Andin? Pse? U kërkon të thonë se çfarë venë re në gjuhën e tekstit të shkruar nga Ariani;*
- nxirren përfundimet se kur përgëzojmë dikë për ditëlindje ose për diçka tjetër, themi se e urojmë, se kur urojmë për diçka, duhet të kemi parasysh se kë urojmë dhe në këtë rast të përdorim një gjuhë të përshtatshme;
- kërkon të zhvillohen ushtrimet nr.3-4 në Fletoren e punës

Vërejtjet e mësues-it/-es :

Llojet e fjalive

Qëllimi: të njohin nxënësit fjalitë dëftore, pyetëse dhe nxitëse, veçoritë e tyre të ndërtimit e të shqiptimit dhe shenjat e pikësimit që vihen në fund të tyre.

Ora e parë

Veprimtaritë e mësues-it/-es:

- pyet nxënësit se çfarë kanë mësuar vitin e kaluar për llojet e fjalive sipas kuptimit dhe kërkon që të japin shembuj;
- nxirren përfundimet se fjalitë dallohen sipas kuptimit, se mund të tregojnë dhe të pyesin për diçka dhe se mund të shprehin ndjenja gëzimi, kënaqësie ose habie për diçka;
- fton nxënësit të lexojnë tekstin “Tri gëzimet” në Librin e nxënësit;
- bën pyetjet: *Për çfarë flet autori në këtë tekst? Ku ndodhet djali? Çfarë po pret? Kë takon tek lumi? Çfarë i thotë? Çfarë ëndërron djali? Çfarë i fali peshkatari? Kë takoi rrugës për në shtëpi? Çfarë i thoshte zëri nga brenda? Si veproi djali? Si ju duket qëndrimi i tij? Si do të vepronit ju në një rast të tillë?*
- kërkon të lexojnë në Librin e nxënësit fjalitë: *Gëzimi i një njeriu nuk zgjat gjithmonë. Pse s’i ndajmë gëzimet bashkë? Merr edhe mollën, edhe peshkun;*
- bën pyetjet: *Përse shërben fjalia e parë? Çfarë shenje pikësimi ka në fund? Çfarë fjalie është?*
- nxirret përfundimi se fjalia *Gëzimi i një njeriu nuk zgjat gjithmonë.*, që shërben për të treguar diçka, është fjali dëftore dhe se fjalia dëftore mbaron me *pikë*;
- bën pyetjet: *Përse shërben fjalia e dytë? Çfarë shenje pikësimi ka në fund? Çfarë fjalie është?*
- nxirret përfundimi se fjalia *Pse s’i ndajmë gëzimet bashkë?* që shërben për të pyetur për diçka, është fjali pyetëse dhe se fjalia pyetëse mbaron me *pikëpyetje*;
- bën pyetjet: *Përse shërben fjalia e tretë? Çfarë shenje pikësimi ka në fund? Çfarë fjalie është?*
- nxirret përfundimi se fjalia *Merr edhe mollën, edhe peshkun.*, që nxit dikë për të bërë diçka, është fjali nxitëse dhe se fjalia nxitëse mbaron me *pikë* ose me *pikëçuditje*. Mësuesi ka parasysh se me fjali nxitëse japim një *urdhër, një këshillë, bëjmë një propozim, një lutje* ose një *ftesë*.

Ora e dytë

Veprimtaritë e mësues-it/-es:

- fton nxënësit të shohin në faqen përkatëse të Librit të nxënësit figurën që flet për fjalinë pyetëse;
- bën pyetjet: *Kush pyet? Çfarë pyet? Kush përgjigjet? Si përgjigjet Zefi? Çfarë tregojnë përgjigjet e Gjystinës, Martinit dhe Ardianit? A kanë të drejtë Gjystina, Martini dhe Ardiani?;*
- nxirret përfundimi se fjalia pyetëse fillon zakonisht me fjalët: *kush, cili, kë, kujt, çfarë, ku, kur, sa, si, pse, përse, a, vallë*, por ajo mund të ndërtohet edhe ndryshe. Mësuesi ka parasysh se fjalia pyetëse mund të ndërtohet edhe pa ndihmën e këtyre fjalëve, me intonacion pyetës etj.;
- kërkon të jepen shembuj fjalish pyetëse që fillojnë me fjalët: *kush, cili, kë, kujt, çfarë, ku, kur, sa, si, pse, përse, a, vallë*;
- fton nxënësit të zhvillojnë ushtrimet nr.1-5 në Fletoren e punës.

Shënim: mësues-i/-ja mund të japë si detyrë shtëpie një ose dy ushtrime nga Fletorja e punës. Kjo gjë varet nga koha që ka në dispozicion, nga karakteri dhe nga përmasa e ushtrimeve.

Vërejtjet e mësues-it/-es :

Fjalitë pohore dhe mohore

Qëllimi: të dallojnë nxënësit fjalitë pohore dhe mohore, veçoritë e tyre dhe t'i përdorin drejt ato në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Mjetet e nevojshme mësimore: materialet për përgatitjen e një pllakati, karton, fllomaster.

Ora e parë

Veprimtaritë e mësues-it/-es:

- pyet nxënësit se çfarë kanë mësuar vitin e kaluar për fjalitë pohore dhe mohore dhe u kërkon të japin shembuj fjalish pohore dhe mohore;
- nxirren përfundimet se fjalia mohore ka kuptim të kundërt me fjalinë pohore, se fjalitë mohore zakonisht marrin *nuk* ose *s'* përpara foljes;
- kërkon të lexojnë në Librin e nxënësit dy grupet e fjalive pohore dhe mohore;
- bën pyetjet: *Çfarë fjalish janë ato të grupit të parë? Si i përcaktuat? Çfarë fjalish janë ato të grupit të dytë? Si i përcaktuat? Ku dallohen fjalitë e grupit të parë nga ato të grupit të dytë?*;
- nxirren përfundimet se fjalitë e grupit të parë janë fjali dëftore, pyetëse dhe nxitëse, se ato pohojnë diçka, se janë, pra, fjali pohore, se fjalitë e grupit të dytë janë gjithashtu dëftore, pyetëse dhe nxitëse, se ato mohojnë diçka, se janë, pra, fjali mohore.
- rithekson se fjalitë dëftore, pyetëse dhe nxitëse mund të jenë pohore dhe mohore dhe se shndërrimi i një fjalie pohore në fjali mohore bëhet me anë të pjesëzave *nuk*, *s' mos* etj.

Ora e dytë

Veprimtaritë e mësues-it/-es:

- u thotë nxënësve të shohin figurën me balona në Librin e nxënësit dhe të lexojnë fjalët e Vjollcës dhe Astritit;
- kërkon të formojnë përkatësisht nga tri fjali: një dëftore, një pyetëse dhe një nxitëse për veprimet e Vjollcës dhe të Astritit veç e veç dhe t'i shkruajnë ato në Fletoren e punës;
- organizon diskutimin rreth fjalive;
- fton nxënësit të zhvillojnë ushtrimet nr.1-5 në Fletoren e punës.

Shënim: mësues-i/-ja mund të japë si detyrë shtëpie një ose dy ushtrime nga Fletorja e punës. Kjo gjë varet nga koha në dispozicion, nga karakteri dhe nga përmasa e ushtrimeve.

Vërejtjet e mësues-it/-es :

Zanoret dhe bashkëtingëlloret

Qëllimi: të ndajnë nxënësit fjalët në rrokje dhe rrokjet në tinguj; të dallojnë zanoret dhe bashkëtingëlloret dhe të njohin veçoritë e tyre.

Mjetet e nevojshme mësimore: materiale të thjeshta dhe praktike që ilustrojnë formimin e tingujve si rezultat i lëvizjeve të organeve të të folurit të ngjashme me ato të Librit të nxënësit për tingujt *a, f, sh*.

Ora e parë

Veprimtaritë e mësues-it/-es:

- kërkon nga nxënësit që të lexojnë katër vargjet e poezisë “Korça” të Naim Frashërit;
- bën pyetjet: *Sa vargje ka kjo strofë e poezisë “Korça”? Çfarë tregojnë vizat në vargjet e poezisë? Si quhen grupet e tingujve të ndara me viza? Sa tinguj ka vargu i parë? Çfarë tingujsh janë ato, zanorë apo bashkëtingëllore? Si quhen shenjat që në të shkruar shënojnë tingujt? Sa tinguj themelorë ka gjuha letrare? Ku dallohen zanoret nga bashkëtingëlloret?;*
- nxirren përfundimet se tingujt janë njësitë më të vogla të të folurit që formojnë fjalët, se shenjat që shënojnë tingujt janë shkronjat, se tingujt e gjuhës letrare ndahen në zanore dhe në bashkëtingëllore, se zanoret janë tingujt që mund të shqiptohen më vete, se bashkëtingëlloret janë tingujt që nuk mund të shqiptohen më vete;
- kërkon nga nxënësit që të lexojnë vargjet e poezisë “Të mësoj” të Azem Shkrelit;
- bën pyetjet: *Sa rrokje ka secili varg? Sa rrokje kanë vetëm zanore? Po rrokjet e tjera si janë formuar? A ka rrokje pa zanore? A mund të formojnë rrokje një grup bashkëtingëlloresh?;*
- nxirret përfundimi se baza e rrokjes është zanorja. Kjo do të thotë se çdo rrokje duhet të ketë patjetër një zanore, se një grup bashkëtingëlloresh pa zanore nuk mund të formojë rrokje, se rrokje quhet tingulli ose tingujt që shqiptohen vetëm me një të hapur të gojës.

Ora e dytë

Veprimtaritë e mësues-it/-es:

- fton nxënësit të lexojnë në Librin e nxënësit tekstin “Si formohen tingujt” dhe organizon diskutimin rreth përmbajtjes së tij. Pas leximit, nxënësit u përgjigjen pyetjeve të mësues-it/es që kanë të bëjnë me përmbajtjen e tekstit dhe vetë parashatrojnë pyetje të tilla;
- kërkon të zhvillohen ushtrimet nr.1-6 në Fletoren e punës.

Vërejtjet e mësues-it/-es :

Ndarja e fjalëve në fund të rreshtit

Qëllimi: të njohin nxënësit rregullat e ndarjes së fjalëve në fund të rreshtit dhe t'i zbatojnë ato në të shkruar.

Mjetet e nevojshme mësimore: tri pllakate të ngjashme me ato të Librit të nxënësit, por me fjali që përmbajnë fjalë të tjera që ilustronë ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit.

Ora e parë

Veprimtaritë e mësues-it/-es:


- kërkon nga nxënësit që të ndajnë në rrokje fjalë të veçanta ose fjalët e një ose dy vargjeve të një poezie;
- rithekson njohuritë e fituara për rrokjen që janë të nevojshme për realizimin e qëllimeve të orës së mësimi për ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit;
- kërkon të shohin pllakatet që ka përgatitur sipas modelit të atyre që janë në Librin e nxënësit;
- bën pyetjet: *Çfarë shenje pikësimi është përdorur për të ndarë fjalët në fund të rreshtit? Ku mbështetet ndarja e fjalëve në fund të rreshti?*
- nxirren përfundimet se për ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit përdoret viza, se ndarja e fjalëve në fund të rreshtit mbështetet kryesisht në ndarjen e fjalëve në rrokje;
- kërkon nga nxënësit që të lexojnë fragmentin për gënjeshtarët në Librin e nxënësit;
- bën pyetjet: *A ndahen në fund të rreshtit fjalët njërrrokëshe? A mund të lihet në fund të rreshtit ose të kalohet në rreshtin tjetër një shkronjë e vetme? Po një grup bashkëtingëlloresh, a mund të kalohet në rreshtin tjetër?;*
- nxirren përfundimet se fjalët njërrrokëshe nuk ndahen në fund të rreshtit, se një shkronjë e vetme nuk mund të lihet në fund të rreshtit as të kalohet në rreshtin tjetër, se është gabim të kalohet në rreshtin tjetër një grup bashkëtingëlloresh pa zanore.

Ora e dytë

Veprimtaritë e mësues-it/-es:

- kërkon nga nxënësit që të zhvillojnë ushtrimet nr.1-4 në Fletoren e punës.

Vërejtjet e mësues-it/-es :



Pjesa e dytë

2

Shkruajmë letra dhe kartolina

Qëllimi: të aftësohen nxënësit që të shkruajnë letra dhe kartolina; të njohin dhe të praktikojnë kërkesat për shkrimin dhe për dërgimin e një letre ose të një kartoline.

Mjetet e nevojshme mësimore: kartolina dhe zarfe të llojeve të ndryshme.

Ora e parë

Veprimtaritë e mësues-it/-es:

- kërkon nga nxënësit që të thonë sesi komunikojnë me të tjerët me shkrim, se kujt i shkruajnë më shpesh, se çfarë i shkruajnë zakonisht, se cilën formë dërgese përdorin më shpesh: *kartolinën, letrën, postën elektronike (i-mailⁱⁿ), SMS-në;*
- kërkon të lexojnë tekstin me titull “*Tori në postë*”;
- bën pyetjet: *Çfarë bën zakonisht Tori në kohën e lirë? Si e presin në postë? Çfarë bën Tori në postë? Çfarë i dhuroi Runi? Çfarë shkroi Tori? Kujt ia drejtoi letrën? Emri i kujt është shkruar në fund të letrës?;*
- kërkon të lexojnë në Librin e nxënësit letrën që Koleci i dërgon Gjergjit në spital;
- bën pyetjet: *Kush e dërgon letrën? Kujt ia dërgon? Çfarë i shkruan? Çfarë është shënuar në anën e djathtë të letrës, sipër? Si përfundon letra? A është e saktë dhe e bukur gjuha e letrës? Sa pjesë ka kjo letër dhe si quhen ato?*
- nxirren përfundimet se letra shkruhet për njerëzit që ndodhen larg, se pjesët përbërëse të letrës janë: *koka, përshëndetja, përmbajtja, mbyllja, nënshkrimi*, se gjuha e letrës duhet të jetë e saktë dhe e bukur.
- kërkon të lexojnë kartolinën që Elvira i dërgon Mirelës;
- bën pyetjet: *Kush e dërgon kartolinën? Kujt ia dërgon? Çfarë i shkruan? Çfarë është shënuar në anën e djathtë të kartolinës, sipër? Si përfundon kartolina? Po ju, a keni shkruar ndonjëherë kartolina? Kujt i keni shkruar? Çfarë i keni shkruar?;*
- nxirren përfundimet se në kartolinë shkruhet zakonisht përshëndetja që i dërgojmë një personi të dashur nga një vend ku kemi shkuar për të kaluar pushimet verore a dimërore ose për ndonjë arsye tjetër, se që të mbërrijë kartolina tek marrësi, të cilit i drejtohet, duhet të shkruhen këto të dhëna: *emri dhe mbiemri i marrësit ose i personit të cilit i dërgohet, rruga dhe numri i shtëpisë, numri i postës a kodi postar dhe vendi ku jeton marrësi*. Nuk duhet të harrojmë të vëmë emrin tonë që marrësi të dijë se kush është dërguesi.

Ora e dytë

Veprimtaritë e mësues-it/-es:

- fton nxënësit që të lexojnë në Librin e nxënësit tekstin “*Letrat*” dhe organizon diskutimin rreth përmbajtjes së tij;
- u kërkon të zhvillojnë ushtrimet nr.1-6 në Fletoren e punës.

Vërejtjet e mësues-it/-es :

Emërtimet e rrugëve dhe të shesheve

Qëllimi: të përvetësojnë dhe të zbatojnë nxënësit rregullat drejtshkrimore lidhur me përdorimin e shkronjës së madhe në fillim të emërtimeve që shënojnë rrugë dhe sheshe.

Mjetet e nevojshme mësimore: një pllakat me fjali me emërtime rrugësh dhe sheshesh në Mal të Zi, një album ose fotografi të Podgoricës.

Ora e parë

Veprimtaritë e mësues-it/-es:

- kërkon nga nxënësit që të thonë emërtimet e rrugëve ku banojnë ata dhe shokët e tyre dhe i fton të shkruajnë në dërrasë të zezë ndonjë prej tyre;
- diskutohet për drejtshkrimin e tyre duke iu referuar njohurive që nxënësit kanë fituar në klasë të tretë për emrat e përveçëm;
- kërkon të shohin pllakatin e përgatitur me emërtime rrugësh dhe sheshesh në Mal të Zi;
- bën pyetje si këto: *Çfarë emrash janë ato me shkronja të kuqe, të përveçëm apo të përgjithshëm? Si janë shkruar ata? Përse janë shkruar me shkronjë të madhe?*;
- nxirret përfundimi se emërtimet e rrugëve dhe të shesheve shkruhen me shkronjë të madhe në fillim;
- kërkon të lexojnë fjalitë me emërtime rrugësh e sheshesh në Librin e nxënësit;
- bën pyetjet: *Çfarë emrash janë ato me shkronja të kuqe në grupin e parë, të përveçëm apo të përgjithshëm? Çfarë emërtojnë emrat e grupit të parë? Si janë shkruar ata? Përse janë shkruar me shkronjë të madhe? Po emrat me shkronja të kuqe në grupin e dytë, çfarë emërtojnë? Çfarë dallimi vini re në shkrimin e emrave të rrugëve dhe të shesheve në të dy rastet?*;
- nxirret përfundimi se emërtimet e rrugëve dhe të shesheve shkruhen me shkronjë të madhe në fillim (*Në qendër të qytetit ndodhet Sheshi i Republikës. Jo larg sheshit është Rruga e Cetinjës*), se kur emrat rrugë, shesh, shëtitore a bulevard nuk janë pjesë përbërëse e emrit të përveçëm shkruhen me shkronjë të vogël, kurse emri i përveçëm shkruhet me shkronjë të madhe dhe vihet midis thonjzash (*Shoku im banon në rrugën "Xhorxh Uashington". Unë banoj në rrugën "Doklea", Ne u njohëm në sheshin "Shën Pjetri i Cetinjës"*);

Ora e dytë

Veprimtaritë e mësues-it/-es:

- fton nxënësit të lexojnë në Librin e nxënësit tekstin "Podgorica" dhe organizon diskutimin rreth përmbajtjes së tij dhe rreth shkrimit të emërtimeve të rrugëve dhe shesheve;
- kërkon të zhvillojnë ushtrimet nr.1-4 në Fletoren e punës.

Vërejtjet e mësues-it/-es :

Shkrimi i datave

Qëllimi: të përvetësojnë dhe të zbatojnë nxënësit rregullat drejtshkrimore lidhur me shkrimin e datave.

Mjetet e nevojshme mësimore: kalendari dhe një pllakat me shkrime datash, por jo njësoj, si në Librin e nxënësit në faqen përkatëse.

Veprimtaritë e mësuesit/-es:

- tregon kalendarin dhe kërkon nga nxënësit që të thonë se çfarë shënojnë datat;
- pyet se ku e kur e shkruajnë datën, a kanë ata ndonjë datë të veçantë dhe çfarë shënon ajo datë për ata etj.;
- kërkon të shohin pllakatin me shkrime datash të përgatitur prej tij;
- kërkon të shohin mënyrat e ndryshme të shkrimit të datave, të thonë se çfarë venë re, se cilën mënyrë të shkrimit të datave përdorin ata më shumë etj.;
- kërkon të shohin mënyrën si janë shkruar datat në Librin e nxënësit;
- nxirren përfundimet se datat janë shifrat që shënojnë *ditët e muajit* sipas radhës në kalendar ose *kohën* kur ka ndodhur një ngjarje e caktuar, se data shkruhet kur u dërgojmë letra ose kartolina njerëzve tanë, se në datat e plota muaji shkruhet me shifra (arabe ose romake), se pas datës dhe muajit vihet pikë (12. 6. 2008 ose 12. VI. 2008 dhe jo 12 / 6 / 2008 ose 12 – VI - 2008) ose me fjalë (12 qershor 2008);
- kërkon të zhvillojnë ushtrimet nr.1-3 në Fletoren e punës.

Vërejtjet e mësues-it/-es :

Ylberi

Qëllimi: të aftësohen nxënësit që të lexojnë dhe të kuptojnë tekstet joletrare dhe të hartojnë vetë tekste joletrare.

Mjetet e nevojshme mësimore: albumi me fotografi që paraqesin ylberin dhe aspekte të mënyrës së formimit të tij.

Ora e parë

Veprimtaritë e mësues-it/-es:

- tregon pamje të ylberit dhe kërkon nga nxënësit që të thonë se çfarë dinë ata për ylberin, çfarë është ylberi, si formohet, sa ngjyra ka, si quhen ato etj.;
- thotë se do të mësojnë diçka më shumë për ylberin dhe kërkon të lexojnë tekstin “Ylberi” në Librin e nxënësit;
- bën pyetjet: *Çfarë është ylberi? Çfarë ngjyre ka drita e diellit? Prej sa ngjyrash përbëhet drita e bardhë? Kush e zbuloi? Si e zbuloi? Si formohet ylberi? Sa ngjyra ka ylberi? Si janë të renditura ngjyrat e ylberit? Përse ylberi ka formën e harkut? Provoni ta vizatoni?;*
- u kërkon të bëjnë ushtrimin e parë në fletoren e punës.

Ora e dytë

Veprimtaritë e mësues-it/-es:

- fton nxënësit që të lexojnë në Librin e nxënësit tekstin “Isak Njuton” dhe organizon diskutimin rreth përmbajtjes së tij.
- kërkon të zhvillojnë ushtrimet nr. 2-3 në Fletoren e punës.

Shënim: mësuesi/-ja mund të japë si detyrë shtëpie një nga ushtrimet e Fletores së punës. Kjo gjë varet nga koha në dispozicion, nga karakteri dhe nga përmasa e ushtrimeve.

Vërejtjet e mësues-it/-es :

Mbiemrat

Qëllimi: të dallojnë nxënësit mbiemrat e nyjshëm dhe të panyjshëm, veçoritë e tyre dhe t'i përdorin drejtë ato.

Ora e parë

Veprimtaritë e mësues-it/-es:

- kërkon nga nxënësit që të thonë se çfarë kanë mësuar vitin e kaluar për mbiemrat, pra, se çfarë tregojnë mbiemrat dhe të japin shembuj me mbiemra, disa prej të cilëve mund të analizohen bashkërisht në klasë;
- nxirret përfundimi se mbiemrat janë fjalë që tregojnë se si janë emrat;
- kërkon të lexojnë ato që ka shkruar Shpresa në ditarin e saj në dy variante të mbajtur gjatë pushimeve në Ulqin;
- bën pyetje: *Cili variant ju pëlqen më shumë? Pse? Cili variant ka më shumë të dhëna? Çfarë tregojnë fjalët e shënuara me ngjyrë blu? Cilat fjalë plotësojnë ato? Çfarë janë fjalët me ngjyrë blu?;*
- nxirren përfundimet se fjalët që qëndrojnë pranë emrave dhe tregojnë si janë sendet janë mbiemra, se mbiemrat janë: të nyjshëm (*i kaltër, i bardhë, i vogël, i qetë, i gëzuar, i bukur*) dhe të panyjshëm (*blu, zemërmirë, bujar, fisnik, trim, heroik, veror, gëlqeror, metalik*) se mbiemrat e nyjshëm marrin përpara nyjat : *i, e, të, së;*
- kërkon të zhvillojnë ushtrimet nr.1-2 në Fletoren e punës.

Ora e dytë

Veprimtaritë e mësues-it/-es:

- kërkon nga nxënësit që të zhvillojnë ushtrimet nr.3-6 në Fletoren e punës.

Vërejtjet e mësues-it/-es :

Foljet

Qëllimi: të dallojnë nxënësit foljet, veçoritë e tyre kuptimore dhe t'i përdorin drejt ato.

Ora e parë

Veprimtaritë e mësues-it/-es:

- kërkon nga nxënësit të thonë se çfarë kanë mësuar vitin e kaluar për foljet, pra, se çfarë tregojnë foljet dhe të japin shembuj me folje, disa prej të cilëve mund të analizohen edhe bashkërisht në klasë;
- nxirret përfundimi se foljet janë fjalë që tregojnë veprime;
- kërkon të rilexojnë ato që ka shkruar Shpresa në ditarin e saj në variantin e dytë të mbajtur gjatë pushimeve në Ulqin;
- bën pyetje: *Çfarë tregojnë fjalët e shkruara me shkronja blu? Cilat nga ato tregojnë veprime? Cilat nga ato tregojnë gjendje?*;
- nxirren përfundimet se kur: *ulesh, lëviz, luan, bën, vrapon, mëson, lexon, ecën, udhëton* kryen veprime, se kur: *ngopesh, gëzohesh, fle, qëndron, ke, do, rritesh* nuk kryen veprime, por je në një gjendje të caktuar, se fjalët që shënojnë veprime ose gjendje janë folje, se kur përdorim foljet: *vetëtin, bubullin, veson, agon, vrenjtet, gjëmon, kthjellon*, flasim për dukuri të natyrës;
- kërkon të zhvillojnë ushtrimet nr.1-2 në Fletoren e punës.

Ora e dytë

Veprimtaritë e mësues-it/-es:

- fton nxënësit të lexojnë në Librin e nxënësit tekstin “*Çfarë është moti*” dhe organizon diskutimin rreth përmbajtjes së tij.
- kërkon të zhvillojnë ushtrimet nr. 3-6 në Fletoren e punës.

Vërejtjet e mësues-it/-es :

Nuk, s' +Folje

Qëllimi: të dallojnë nxënësit pjesëzat mohuese nuk, s' dhe t'i përdorin drejt ato në gjuhën e tyre të shkruar.

Ora e parë

Veprimtaritë e mësues-it/-es:

- kërkon nga nxënësit që të thonë se çfarë kanë mësuar në fillim të vitit për fjalitë pohore dhe mohore dhe të japin shembuj me fjali mohore;
- kërkon të shkruajnë në dërrasë të zezë disa fjali mohore të thëna nga nxënësit që përmbajnë pjesëzat *nuk* dhe *s'*;
- bën pyetjen: *A janë shkruar drejtë pjesëzat nuk dhe s'?*;
- nxirret përfundimi se pjesëza mohuese *nuk* në të gjitha rastet shkruhet e ndarë nga folja, po kështu edhe pjesëza mohuese *s'* shkruhet e ndarë nga folja, po pas saj vihet apostrof *s'*;
- kërkon të lexojnë dy grupet e fjalive në vazhdim;
- bën pyetjet: *Çfarë fjalish janë? Si e përcaktuat llojin e këtyre fjalive? A është e mundur të zëvendësoni nuk me s'? Provojeni. A priset kuptimi i fjalive?*
- kërkon të zhvillojnë ushtrimet nr. 1-3 në Fletoren e punës.

Vërejtjet e mësues-it/-es :

Përemrat vetorë

Qëllimi: të dallojnë nxënësit përemrat vetorë kuptimin dhe veçoritë e tyre dhe t'i përdorin drejt ato në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Ora e parë

Veprimtaritë e mësues-it/-es:

- kërkon nga nxënësit të thonë se çfarë kanë mësuar vitin e kaluar për fjalët që zëvendësojnë emrat, d.m.th. për përemrat vetorë në numrin njëjës dhe shumës;
- kërkon të lexojnë në Librin e nxënësit fjalitë: *Arbi shkoi në cirk. Ai shkoi në cirk. Zana shkoi në kinema. Ajo shkoi në kinema. Driti dhe Gëzimi shkuan në teatër. Ata Shkuan në teatër;*
- bën pyetjet: *Kush shkoi në cirk? Kush shkoi në kinema? Kush shkoi në teatër? Çfarë zëvendësojnë fjalët ai, ajo, ata? Çfarë janë fjalët ai, ajo, ata?*
- nxirret përfundimi se fjalët *ai, ajo, ata* zëvendësojnë emrat *Dritani, Zana, Driti dhe Gëzimi. Ai, ajo, ata* janë përemra vetorë;
- kërkon të lexojnë fjalitë në vijim në Librin e nxënësit;
- bën pyetjet: *Çfarë janë fjalët me shkronja të kuqe? Sa përemra vetorë ka gjuha shqipe?;*
- kërkon të shohin tabelën e përemrave vetorë, ku shënohen vetat dhe numri i përemrave vetorë;
- bën pyetjet: *Sa veta ka përemri vetor? Cilët janë përemrat vetorë të vetës së parë? Cilët janë përemrat vetorë të vetës së dytë? Cilët janë përemrat vetorë të vetës së tretë? Cilët janë përemrat vetorë të numrit njëjës? Cilët janë përemrat vetorë të numrit shumës?*

Ora e dytë

Veprimtaritë e mësues-it/-es:

- u kërkon të bëjnë ushtrimet 1-4 në fletoren e punës.

Vërejtjet e mësues-it/-es :

Pjesa e tretë

33

Zanatet ose mjeshtëritë

Qëllimi: të zhvillojnë nxënësit aftësinë për të folur qartë dhe në mënyrë të kuptueshme, të lexojnë e kuptojnë tekstet joletrare, t'i dallojnë të dhënat kryesore në një tekst, të përshkruajnë në mënyrë të pavarur, në këtë rast një zanat ose mjeshtëri.

Mjetet e nevojshme mësimore: albumi me pamje nga zanatet ose mjeshtëritë e ndryshme që ushtrohen edhe sot në Mal të Zi.

Ora e parë

Veprimtaritë e mësues-it/-es:

- pyet nxënësit se çfarë dinë për zanatet ose mjeshtëritë, çfarë janë ato, çfarë zanatesh ushtrohen në Mal të Zi, nëse kanë qenë ndonjëherë në dyqanin e ndonjë zanatçiu ose mjeshtri, çfarë u ka bërë përshtypje etj.
- propozon të shohin albumin ose fotografi me pamje nga zanatet ose mjeshtëritë e ndryshme dhe të bëjnë komentet përkatëse;
- kërkon të lexojnë në Librin e nxënësit tekstin “Argjendaria”;
- bën pyetjet: *Çfarë bëjnë argjendarët? Çfarë materialesh përdorin? Me çfarë veglash punojnë? Ku ka qenë e zhvilluar zeja e argjendarisë? Çfarë objektesh të punuara me ar e argjend ruhen në muzetë?*
- kërkon të shohin në Librin e nxënësit figurat që tregojnë zanate të ndryshme, si: murator, zdrukthëtar etj.;
- bën pyetjet: *Si quhen ata që bëjnë këto punë? Kush dëshiron të bëhet mjek/-e? Pse? Kush dëshiron të bëhet rrobaqepës/-e? Pse? A ka ndonjë që dëshiron të bëhet aviator/-e? Pse? Po ju të tjerët çfarë dëshironi të bëheni? Thoni pse.*
- thotë të shohin në Librin e nxënësve figurat ku tregohen një bojaxhi, një infermiere dhe një elektrikist;
- bën pyetjet: *Ç’punë bëjnë Miri, Genta dhe Ardi? Cilin prej këtyre profesioneve do të preferonit ju ? Pse?*

Ora e dytë

Veprimtaritë e mësues-it/-es:

- kërkon nga nxënësit që të bëjnë ushtrimet nr. 1-3 në Fletoren e punës;
- përcakton skemën bazë për përshkrimin e zanateve ose të mjeshtërive që do të ishte pak a shumë kjo: materialet që duhen, mjetet ose veglat që përdoren, veprimet që kryhen, vendi i punës, objektet që prodhohen;
- jep detyrë që të mblidhen të dhënat për njërin nga zanatet ose mjeshtëritë që ata preferojnë sipas skemës bazë.

Ora e tretë

Veprimtaritë e mësues-it/-es:

- kërkon nga nxënësit që të shkruajnë në Fletoren e punës për zanatin ose mjeshtërinë e tyre të preferuar duke pasur parasysh skemën bazë dhe të dhënat që kanë mbledhur ata vetë.
- bëhet vlerësimi i punës së bërë nga ana e nxënësve.

Vërejtjet e mësues-it/-es :

Kryefjala

Qëllimi: të dallojnë nxënësit kryefjalën; të dinë se çfarë tregon dhe si ndërtohet kryefjala.

Ora e parë

Veprimtaritë e mësues-it/-es:

- pyet se çfarë kanë mësuar vitin e kaluar për kryefjalën dhe kallëzuesin, pra, çfarë tregon kryefjala dhe çfarë tregon kallëzuesi dhe të japin shembuj me fjali të thjeshta të përbëra nga kryefjalë dhe kallëzues;
- nxirren përfundimet se kryefjalë e fjalisë është fjala që tregon se kush e kryen veprimin, kurse kallëzues i fjalisë është fjala që tregon veprimin;
- kërkon të shohin figurat dhe fjalitë që i shoqërojnë në Librin e nxënësit;
- bën pyetjet: *Kush qep? Kush gatuan? Kush vizaton? Çfarë janë fjalët: rrobaqepësja, kuzhinieri, piktori? Çfarë pyetjeje i përgjigjen? Çfarë tregojnë emrat: rrobaqepësja, kuzhinieri, piktori? Çfarë funksioni kryejnë në fjali emrat: rrobaqepësja, kuzhinieri, piktori?*;
- nxirren përfundimet se kryefjala tregon kush e kryen veprimin ose për kë a për çfarë flitet në fjali dhe se kryefjala i përgjigjet pyetjes *kush?, cili?*;
- kërkon të lexojnë tekstin “Në muzeun e Budvës”;
- kërkon të gjejnë kryefjalët e fjalive të tekstit dhe bën pyetjet: *Nga sa fjalë përbëhen kryefjalët që gjetët? Çfarë janë kryefjalët që gjetët, emra apo përemra?*;
- nxirren përfundimet se kryefjala tregon se kush e kryen veprimin ose për kë a për çfarë flitet në fjali, se kryefjala mund të përbëhet nga një fjalë (*muzeu, nxënësit* etj.) ose më shumë fjalë (*të gjitha objektet*), se kryefjala është zakonisht një emër (*muzeu, nxënësit, vajzat* etj.), por mund të jetë edhe një përemër (*ata*).

Ora e dytë

Veprimtaritë e mësues it/-es:

- kërkon nga nxënësit që të zhvillojnë ushtrimet nr. 1-4 në Fletoren e punës.

Vërejtjet e mësues-it/ -es :

Kallëzuesi

Qëllimi: të dallojnë nxënësit kallëzuesin; të dinë se çfarë tregon dhe si ndërtohet kallëzuesi.

Ora e parë

Veprimtaritë e mësues-it/-es:

- pyet nxënësit se çfarë kanë mësuar vitin e kaluar për kallëzuesin, pra, çfarë tregon kallëzuesi dhe u kërkon shembuj me fjali të thjeshta të përbëra nga kryefjala dhe nga kallëzuesi;
- nxirret përfundimi se kallëzuesi i fjalisë është fjala që tregon veprimin;
- kërkon të shohin figurat dhe fjalitë që i shoqërojnë në Librin e nxënësit;
- bën pyetjet: *Çfarë bëjnë fëmijët? Çfarë bëjnë zogjtë? Çfarë bëjnë dhentë? Çfarë janë fjalët: luajnë, fluturojnë, blegërijnë? Çfarë pyetjeje i përgjigjen? Çfarë tregojnë foljet: luajnë, fluturojnë, blegërijnë? Çfarë funksioni kryejnë në fjali foljet: luajnë, fluturojnë, blegërijnë?;*
- nxirren përfundimet se fjalët: *luajnë, fluturojnë, blegërijnë* që tregojnë se çfarë bëjnë *fëmijët, zogjtë, dhentë* janë kallëzues të fjalive, se kallëzuesi i përgjigjet pyetjeve *çfarë bën?* dhe është zakonisht një folje;
- kërkon të lexojnë në Librin e nxënësit fjalitë në vijim: *Dielli shkëlqen. Fëmijët janë të lumtur. Dhentë mërzejnë.*
- kërkon të gjejnë kryefjalët dhe kallëzuesit e këtyre fjalive dhe bën pyetjet: *Si janë ndërtuar kallëzuesit e këtyre fjalive? Çfarë tregojnë kallëzuesit e këtyre fjalive?;*
- nxirren përfundimet se pjesa e fjalisë, me të cilën tregohet diçka për kryefjalën është kallëzuesi, se kallëzuesi tregon çfarë bën kryefjala, po edhe në çfarë gjendjeje ndodhet ose çfarë cilësie ka, se kjo gjë tregohet zakonisht me anë të foljes, por mund të tregohet edhe me mbiemra dhe me emra.

Ora e dytë

Veprimtaritë e mësues-it/-es:

- kërkon nga nxënësit që të zhvillojnë ushtrimet nr.1-5 në Fletoren e punës.

Vërejtjet e mësues-it/-es :

Fjalja e zgjeruar

Qëllimi: të njohin nxënësit veçoritë e fjalisë së zgjeruar dhe ta dallojnë fjalinë e zgjeruar nga fjalia e thjeshtë.

Ora e parë

Veprimtaritë e mësues-it/-es:

- pyet nxënësit se çfarë kanë mësuar vitin e kaluar për fjalinë e thjeshtë dhe të zgjeruar, pra, çfarë është fjalia e thjeshtë, si është e ndërtuar, çfarë është fjalia e zgjeruar, si është e ndërtuar, ku dallohet fjalia e zgjeruar nga fjalia e thjeshtë dhe u kërkon shembuj me fjali të thjeshta dhe me fjali të zgjeruara;
- nxirren përfundimet se fjalia që ka vetëm kryefjalën dhe kallëzuesin është fjali e thjeshtë, se fjalia që ka përveç kryefjalës dhe kallëzuesit edhe fjalë të tjera, është fjali e zgjeruar;
- kërkon që në Librin e nxënësit të lexojnë fjalinë *Rrobaqepësja qep.*;
- kërkon të gjejnë kryefjalën dhe kallëzuesin e kësaj fjalie dhe bën pyetjet: *Përveç kryefjalës dhe kallëzuesit, a ka fjalë të tjera? Çfarë fjalie është?*;
- rithekson përfundimin se fjalia që është e përbërë vetëm nga kryefjala dhe nga kallëzuesi, është fjali e thjeshtë (*Rrobaqepësja qep.*);
- kërkon të lexojnë në Librin e nxënësit fjalinë *Rrobaqepësja ime qep bukur.*;
- kërkon të gjejnë kryefjalën dhe kallëzuesin e kësaj fjalie dhe bën pyetjet: *Përveç kryefjalës dhe kallëzuesit, a ka fjalë të tjera? Çfarë fjalie është?*;
- nxirret përfundimi se fjalia e përbërë nga kryefjala, kallëzuesi dhe fjalët e tjera që kanë lidhje me kryefjalën ose me kallëzuesin, është fjali e zgjeruar (*Rrobaqepësja ime qep bukur.*);
- analizon fjalitë që vijnë në Librin e nxënësit dhe përforcon përfundimin e arritur për fjalinë e zgjeruar.

Ora e dytë

Veprimtaritë e mësues-it/-es:

- u kërkon të bëjnë ushtrimet 1-5 në fletoren e punës.

Vërejtjet e mësues-it/-es :

Plotësojmë formularë

Qëllimi: të lexojnë dhe të kuptojnë nxënësit tekstet; të dallojnë të dhënat kryesore në një tekst dhe të shkruajnë vetë tekste; të plotësojnë në mënyrë të pavarur formularë me kërkesa personale.

Mjetet e nevojshme mësimore: formularë bosh ose të plotësuar me të dhënat personale.

Ora e parë

Veprimtaritë e mësues-it/-es:

- pyet se çfarë dinë për cirkun, a kanë qenë ndonjëherë në ndonjë cirk, çfarë u ka bërë për-shtypje etj.
- kërkon të lexojnë në Librin e nxënësit tekstin *Cirku “Medrano”*;
- bën pyetjet: *Si quhet cirku që do të japë shfaqje në Podgoricë? Nga janë artistët e cirkut? Kush e drejton? Pse e kërkojnë në shumë vende? Ku do të japë shfaqje sivjet cirku? Çfarë do të ketë në program? Çfarë u pëlqen më shumë fëmijëve? Sa njerëz kanë ndjekur shfaqjet e tij?*;
- kërkon të lexojnë dhe të analizojnë formularin e plotësuar nga Gjoni;
- vijon me pyetjet: *Për çfarë kërkohen zakonisht të dhënat e tilla personale? A ju kanë kërkuar të dhëna të tilla ndonjëherë? Kur i kanë kërkuar? Për çfarë i kanë kërkuar? Veç këtyre, a ju kanë kërkuar të dhëna të tjera?*

Ora e dytë

Veprimtaritë e mësues-it/-es:

- kërkon nga nxënësit që të lexojnë në Librin e nxënësit tekstin *“Zbutësi i arinjve”*;
- organizon diskutimin rreth tekstit;
- kërkon të zhvillojnë ushtrimet nr. 1-2 në Fletoren e punës;

Vërejtjet e mësues-it/-es :

Emërtimet e festave

Qëllimi: të përvetësojnë dhe të zbatojnë nxënësit rregullat drejtshkrimore lidhur me përdorimin e shkronjës së madhe tek emërtimet e festave.

Mjetet e nevojshme mësimore: pllakati me emërtime festash kombëtare e ndërkombëtare të Malit të Zi dhe pllakati me emërtimet e festave fetare.

Ora e parë

Veprimtaritë e mësues it/-es:

- kërkon nga nxënësit të thonë se çfarë janë festat dhe çfarë festash festohen në Mal të Zi;
- fton nxënësit që emërtimet e disa festave kryesore në Mal të Zi t'i shkruajnë në dërrasë të zezë;
- organizon diskutimin për drejtshkrimin e emërtimeve të festave, duke iu referuar njohurive që kanë fituar në klasë të tretë për emrat e përveçëm;
- kërkon të shohin pllakatin që ka përgatitur me emërtime festash kombëtare dhe ndërkombëtare në Mal të Zi dhe organizon diskutimin për drejtshkrimin e tyre;
- nxirret përfundimi se emërtimet e festave shkruhen me shkronjë të madhe;
- kërkon të shohin në Librin e nxënësit kalendarin ku janë shënuar festat kryesore kombëtare dhe ndërkombëtare në Mal të Zi;
- bën pyetjet: *Cilat festa janë kombëtare dhe cilat janë ndërkombëtare? Si janë shkruar pjesët përbërëse të emrave të festave kombëtare dhe ndërkombëtare?*;
- nxirret përfundimi se pjesët përbërëse të emërtimeve të festave kombëtare dhe ndërkombëtare shkruhen me shkronjë të madhe : *Viti i Ri, Dita e Pavarësisë, Dita Ndërkombëtare e Grave*, por edhe *8 Marsi, 1 Qershori* etj.

Ora e dytë

Veprimtaritë e mësues-it/-es:

- kërkon nga nxënësit që të vështrojnë pllakatin që ka përgatitur me emërtimet e festave fetare në Mal të Zi dhe organizon diskutimin për drejtshkrimin e tyre;
- nxirret përfundimi se emërtimet e festave fetare shkruhen me shkronjë të vogël;
- kërkon të shohin në Librin e nxënësit tabelën me emërtime festash fetare;
- bën pyetjet: *Çfarë festash janë këto? Si janë shkruar pjesët përbërëse të emërtimeve të festave fetare?*
- nxirret përfundimi se pjesët përbërëse të emërtimeve të festave fetare shkruhen me shkronjë të vogël: *krishtlindjet, bajrami i vogël, pashkët katolike* etj.
- kërkon të zhvillojnë ushtrimet nr.1-4 në Fletoren e punës.

Vërejtjet e mësues-it/-es :

Zanorja ë dhe bashkëtingëlloret ll/dh

Qëllimi: të shqiptojnë dhe të shkruajnë nxënësit si duhet zanoren ë dhe bashkëtingëlloret ll/dh.

Mjetet e nevojshme mësimore: një tabelë e ngjashme me atë në librin e nxënësit ku ilustrohet përmes shembujve të tjerë përdorimi i zanores ë dhe i bashkëtingëlloreve ll/dh.

Ora e parë

Veprimtaritë e mësues-it/-es:


- kërkon nga nxënësit të shohin tabelën që ka përgatitur me shembuj që ilustrojnë përdorimin e zanores ë dhe të bashkëtingëlloreve ll/dh;
- organizon diskutimin rreth shqiptimit dhe shkrimit të tyre;
- kërkon të shohin në Librin e nxënësit tabelën me shembujt që ilustrojnë përdorimin e ë, ll, dh;
- bën pyetjet: *Si shqiptohen emrat e tabelës së parë?* U kërkon të shohin dhe të krahasojnë shkrimin e tyre, të thonë a janë shkruar drejt;
- i pyet: *Çfarë dallimesh vini re në shkrimin e këtyre emrave në tabelën e dytë? A janë shkruar drejt emrat në këtë tabelë?*
- nxirren përfundimet se, kur shqiptojmë emrat *klasë, çantë* zanorja -ë nuk dëgjohet aq mirë. Prandaj, disa fëmijë këto fjalë i shkruajnë gabimisht pa – ë, se rregullat e gjuhës kërkojnë që emrat e gjinisë femërore, si: *klasë, çantë* etj. të shkruhen më ë në fund, se në disa krahina, në vend të *dh* shqiptohet *ll* ose në vend të *ll* shqiptohet *dh*, se prandaj disa fëmijë në vend të *dhoma, dhëmbi* shkruajnë gabimisht *lloma, llami*. Po kështu, duhet të shkruhen me *ll* dhe jo me *dh* fjalët: *llambë, llastikë, llamarinë, mollë* etj.;

Ora e dytë

Veprimtaritë e mësues-it/-es:

- kërkon nga nxënësit që të zhvillojnë ushtrimet nr.1-5 në Fletoren e punës.

Vërejtjet e mësues-it/-es :



Pjesa e katërt

41

Çfarë është gjuha?

Qëllimi: të lexojnë e kuptojnë nxënësit tekstet joletrare; të njohin format e teksteve joletrare dhe të zhvillojnë aftësinë e të menduarit logjik; të kuptojnë se çfarë është gjuha dhe cili është roli i saj në shoqëri.

Mjetet e nevojshme mësimore: CD^{-ë} ose kasetë me incizime këngësh në gjuhë të ndryshme.

Ora e parë

Veprimtaritë e mësues-it/-es:

- propozon që nxënësit të dëgjojnë këngë në gjuhë të ndryshme dhe pyet për gjuhën në të cilën këndohen, a i kuptojnë apo jo dhe pse nuk i kuptojnë;
- nxirren përfundimet se gjuha është mjet komunikimi, se njohja e gjuhëve na ndihmon të kuptojmë dhe të komunikojmë me të tjerët;
- kërkon të lexojnë në Librin e nxënësit tekstin me titull "Gjuha mjet komunikimi";
- bën pyetjet: *Çfarë është gjuha? Përse shërben ajo? A flasin të gjithë njerëzit të njëjtën gjuhë? Ku dallohet gjuha e folur nga gjuha e shkruar? A janë të rëndësishme rregullat gramatikore? Pse?*
- kërkon të zhvillojnë ushtrimet nr.1-3 në Fletoren e punës.

Ora e dytë

Veprimtaritë e mësues-it/-es:

- kërkon nga nxënësit që të lexojnë në Librin e nxënësit tekstin "Nga belbëzimet tek të folurit";
- organizon diskutimin rreth tekstit.

Vërejtjet e mësues-it/-es :

Gjuha amtare

Qëllimi: të lexojnë e kuptojnë nxënësit tekstet joletrare; të njohin format e teksteve joletrare dhe të zhvillojnë aftësinë e të menduarit logjik; të kuptojnë se çfarë është gjuha amtare dhe cili është roli e saj në shoqëri.

Mjetet e nevojshme mësimore: CD^e ose kasetë me incizimin e një kënge në gjuhën shqipe dhe të një kënge në një gjuhë të huaj për nxënësit.

Ora e parë

Veprimtaritë e mësues-it/-es:

- propozon që nxënësit të dëgjojnë një këngë në gjuhën shqipe dhe një tjetër në një gjuhë të huaj për nxënësit dhe pyet për gjuhën në të cilën këndohen dhe pse njërin e kuptojnë dhe tjetrën jo;
- nxirret përfundimi se ata e kuptojnë këngën e kënduar në gjuhën shqipe, sepse është e incizuar në gjuhën e tyre amtare;
- kërkon të lexojnë në Librin e nxënësit tekstin me titull “Gjuha amtare”;
- bën pyetjet: *Ku flitet sot gjuha shqipe? Si quhej gjuha shqipe në Mesjetë? Cili është libri i parë i botuar shqip? Çfarë miratoi Kongresi i Manastirit? Çfarë miratoi Kongresi i Drejtshkrimit?*

Ora e dytë

Veprimtaritë e mësues-it/-es:

- kërkon nga nxënësit që të lexojnë në Librin e nxënësit tekstin “Kongresi i Alfabetit”;
- organizon diskutimin rreth tekstit;
- kërkon të zhvillojnë ushtrimet nr.1-3 në Fletoren e punës.

Vërejtjet e mësues-it/-es :

Kuptimet e fjalës

Qëllimi: të mësojnë nxënësit se fjalët kanë kuptime të ndryshme; të ushtrohen në dallimin e kuptimit të fjalëve.

Ora e parë

Veprimtaritë e mësues-it/-es:

- kërkon nga nxënësit të thonë fjali që përmbajnë fjalën *grykë* ku kjo fjalë përdoret me kuptime të ndryshme dhe t'i shkruajnë ato në dërrasë të zezë;
- kërkon të thonë kuptimin e fjalës *grykë* në çdo fjali që kanë shkruar;
- nxirret përfundimi se fjala *grykë* ka disa kuptime: *fyt, pjesë e shishes ose e një ene tjetër, pjesë e këmishës, pjesë e malit* etj.;
- kërkon të lexojnë në Librin e nxënësit fjalitë *Iu ngritën flokët nga era. Filluan të binin flokët e para të borës.*;
- bën pyetjet: *Çfarë kuptimi ka fjala flokë në fjalinë e parë? Çfarë kuptimi ka fjala flokë në fjalinë e dytë? Sa kuptime ka fjala flokë në këto dy fjali? Cili është kuptimi kryesor i fjalës flokë?*
- nxirret përfundimi se një fjalë mund të ketë shumë kuptime (flokë =1. *qimet e kokës së njeriut; 2. fije bore.*) dhe se kuptimi kryesor i fjalës *flokë* është *qimet e kokës së njeriut*;
- kërkon të thonë kuptimet e fjalës *pullë* dhe me cilën figurë lidhet secili prej tyre, *njollë ose shenjë në trupin e një kafshe, pullë poste, kopsë ose komçë*. Të kihet parasysh se *pullë* në kuptimin e fundit nuk është letrare;

Ora e dytë

Veprimtaritë e mësues-it/-es:

- kërkon nga nxënësit që të lexojnë në Librin e nxënësit fjalitë me fjalën *lule*;
- kërkon të thonë kuptimin e fjalës *lule* në fjalitë e dhëna;
- nxirret përfundimi se kuptimi i fjalës del më mirë në fjali dhe kërkon të japin shembuj;
- kërkon të zhvillojnë ushtrimet nr.1-3 ne Fletoren e punës.

Vërejtjet e mësues-it/-es :

Gjuhët e huaja

Qëllimi: të lexojnë e kuptojnë nxënësit tekstet joletrare; të njohin format e teksteve joletrare dhe të zhvillojnë aftësinë e të menduarit logjik; të kuptojnë se çfarë janë gjuhët e huaja, çfarë janë gjuhët botërore dhe cilat janë gjuhët botërore.

Mjetet e nevojshme mësimore : gazeta, libra, revista CD^ë në gjuhë të ndryshme të huaja.

Ora e parë

Veprimtaritë e mësues-it/-es:

- propozon që nxënësit të dëgjojnë ndonjë tekst në një nga gjuhët e huaja dhe i pyet a i kuptojnë apo jo dhe pse nuk e kuptojnë;
- nxirret përfundimi se nuk e kuptojnë tekstin, sepse ai nuk është në gjuhën e tyre amtare, por në një gjuhë të huaj (anglisht, italisht ose një gjuhë tjetër);
- kërkon të shohin në Librin e nxënësit figurën me përshëndetjet nga larg në gjuhën mala-zeze, në anglisht dhe në shqip;
- bën pyetjet: *Ku dallohen këta tre fëmijë? Përveç ngjyrës dhe syve, a kanë diçka tjetër që i dallojnë? A i kuptoni ju mesazhet e tyre? Cilën nga këto përshëndetje nuk kuptoni? Pse? Në çfarë gjuhe janë shkruar?;*
- nxirret përfundimi se ata tre fëmijët dallohen nga ngjyra, nga sytë, por edhe nga gjuha që flasin, se ata nuk e kuptojnë përshëndetjen në anglisht, sepse është në gjuhë të huaj. Nëse ka fëmijë që e kuptojnë përshëndetjen anglisht, kjo ndodh sepse ata e kanë mësuar këtë gjuhë;
- u kërkon të lexojnë në Librin e nxënësit tekstin “Gjuha e huaj”;
- bën pyetjet: *Çfarë është gjuha e huaj? Çfarë gjuhe të huaj mësoni ju në shkollë? Ku flitet ajo? Çfarë materialesh përdorni për të mësuar atë gjuhë? Çfarë dallimi ka midis mësimin të gjuhës amtare dhe gjuhës së huaj? Cilat gjuhë quhen botërore? Pse quhen gjuhë botërore?*

Ora e dytë

Veprimtaritë e mësues-it/-es:

- kërkon nga nxënësit që të zhvillojnë ushtrimet nr. 1-6 ne Fletoren e punës.

Vërejtjet e mësues-it/-es :

Pse i mësojmë gjuhët e huaja?

Qëllimi: të mësojnë nxënësit rëndësinë dhe rolin e gjuhëve të huaja.

Ora e parë

Veprimtaritë e mësues-it/-es:

- pyet nxënësit nëse shohin emisione televizive në gjuhë të huaja, çfarë shohin dhe a i kuptojnë;
- nxirret përfundimi se ata nuk i kuptojnë emisionet televizive, sepse ato nuk janë në gjuhën e tyre amtare, por në një gjuhë të huaj (anglisht, italisht ose në një gjuhë tjetër);
- kërkon të shohin figurën në Librin e nxënësit ku Berti, Viola dhe Arbi janë duke parë përkatësisht, emisione televizive në gjuhën shqipe, në gjuhën malazeze dhe në anglisht;
- bën pyetjet: *Çfarë po bëjnë Berti, Viola dhe Arbi? Në çfarë gjuhe janë emisionet që po shohin? A i kuptojnë ato? Po ju a shihni emisione në gjuhë të huaj? Çfarë emisionesh shihni? A i kuptoni? Si i kuptoni? A duhet gjuha e huaj në këtë rast? Çfarë gjuhe të huaj mësoni ju në shkollë? A shihni emisione televizive në atë gjuhë? Sa ju ndihmon gjuha që keni mësuar deri tani në shkollë?*
- kërkon të shohin në Librin e nxënësit figurën ku jepet ideja e bisedimeve në distancë me të huaj;
- bën pyetjet: *A keni të afërt, shokë, miq që jetojnë jashtë shteti? Ku jetojnë? Çfarë gjuhe flasin? A komunikoni ju me ta? Si komunikoni ju me ata që nuk flasin shqip? Çfarë probleme keni gjatë komunikimit tuaj me ta?*

Ora e dytë

Veprimtaritë e mësues-it/-es:

- kërkon nga nxënësit që të zhvillojnë ushtrimet nr. 1-4 në Fletoren e punës.

Vërejtjet e mësues-it/-es :

Në restorant

Qëllimi: të mësojnë nxënësit rëndësinë dhe rolin e gjuhëve të huaja në veprimtarinë praktike, sidomos gjatë udhëtimeve jashtë shtetit dhe gjatë kontakteve me të huajt.

Ora e parë

Veprimtaritë e mësues it/-es:

- pyet nxënësit se ku e hanë zakonisht drekën ose darkën dhe sa herë hanë drekën ose darkën në restorant, në çfarë restoranti, si veprojnë për të zgjedhur gjellën ose pijen që dëshirojnë, kur menya është në gjuhë të huaj a e kuptojnë atë dhe se si veprojnë në këtë rast për të zgjedhur gjellën ose pijen që dëshirojnë;
- kërkon të shohin në Librin e nxënësit menynë në shqip, në gjuhën malazeze, në italisht dhe në anglisht;
- bën pyetjet: *Përse shërben menya? Në çfarë gjuhe është?*;
- kërkon të lexojnë në Librin e nxënësit tekstin e shkurtër për vizitën e Besës në Paris;
- bën pyetjet: *Si vepron ajo? A e ndihmon menya? Në çfarë gjuhe është zakonisht menya? Po ju si do të vepronit në këtë rast?*;
- nxirret përfundimi se gjuhët e huaja duhen mësuar, sepse na ndihmojnë të komunikojmë me të huajt dhe të orientohemi me lehtësi kur shkojmë jashtë vendit.

Vërejtjet e mësues-it/-es :

ZGJIDHJET E USHTRIMEVE TË FLETORES SË PUNËS

Zgjerohmë njohuritë tona

1. a. zhvillimi; b. përfundimi; c. hyrja.

2. paragraf; ide.

3. a) tre paragrafë; b) paragrafi i parë; c) nga paragrafi i dytë;

ç) Qeni i teta Bardhës është i madh dhe me ngjyrë të zezë;

d) Nuk duhet të kemi frikë, por duhet të jemi të kujdesshëm.

4. Shkodra ndodhet buzë Liqenit të Shkodrës, pranë lumenjve Drin dhe Buna. / Lumi Buna buron nga liqeni i Shkodrës dhe derdhet në detin Adriatik. Ai është 44 km i gjatë. Rrjedha e poshtme e Bunës ndan kufirin me Malin e Zi. Buna ka qenë e lundrueshme për anijet e vogla tregtare. Ajo bashkohet me Drinin 2 km larg qytetit. / Në hyrje të Shkodrës gjendet kodra shkëmbore e kalasë së Rozafës. Rreth 30 km në juglindje ndodhet Deti Adriatik me Plazhin e Velipojës.

b. tre paragrafë

Gjuha letrare

1.

- Mirëmëngjesi fëmijët e mi!

- Mirëmëngjesi gjyshe!

- A dini sa është ora?

- Po, gjyshe.

2. AJRI, BALLKON, ÇELËS, FSHIJ, BANJË, FSHEH, DIGJEM

3. prindërit, doli, kukullën, këpuste, të bukura, të lidhte, ta ndihmonte

Shkronja e madhe

3. Zeta

Buron poshtë malit Vojnik. Kalon pranë Nikshiqit dhe pastaj zhduket nën tokë, por del përsëri dhe derdhet në lumin Moraça në afërsi të Podgoricës

Moraça

Buron rrëzë malit Llolla. Kalon nëpër ngushtica dhe formon kanionin e Pllatijes. Në afërsi të Podgoricës në Moraçe derdhet lumi i Zetës dhe së bashku derdhen në Liqenin e Shkodrës

4. Mali i Zi, të Gadishullit Ballkanik, të Detit Adriatik, Kroacinë, Bosnje Hercegovinën, Serbinë, Kosovën, Shqipërinë, të Malit të Zi, Nikshiqi, Pljevlja, Podgorica, Cetinja

5. Bari, Berane, Bjello Pole, Budva, Cetinje, Danillovgradi, Herceg Novi, Kollashini, Kotori, Mojkovaci, Nikshiqi, Plava, Plluzhinë, Plevla, Podgorica, Rozhajë, Tivati, Shavniku, Ulqini, Zhablaku

Lutemi dhe urojmë

1. lutemi; 3. urim

Llojet e fjalive

1. pyetëse; dëftore; nxitëse.

pyetëse; pyetëse; nxitëse.

pyetëse; dëftore; pyetëse.

2. Kur vilet rrushi?

Si është qielli?

Sa dritare ka klasa jonë?

Ku kanë shkuar dallëndyshet?

Pse (për ç'arsye, nga se) përkulen pemët?

3. A e kanë mbuluar tokën gjethet?

A kanë shkuar larg dallëndyshet?

A shkojnë fëmijët në shkollë rregullisht?

4. Pusho tani!
Na, merre portokallin.
Nisu tani.
Kujdes se mos vonohesh.

Fjalitë pohore dhe mohore

1. Në fillim Toka nuk ka qenë si sot (M). Është dashur punë e madhe për ta bërë të banueshme (P). S'kishte ura për të kapërcyer lumenjtë (M). S'kishte rrugë për t'u ngjitur në mal (M). Doje të uleshe (P). S'kishte as stol, as karrige (M). S'kishte shtrat të flije (M). Nuk kishte as këpucë, as çizme (M). Nuk gjeje syze askund për sytë (M). S'kishte top që të luaje (M). Mungonte kusia e zjarri për të gatuar (P). Mungonte edhe vetë buka (P). S'kishte gjë prej gjëje (M). Ishin vetëm njerëzit me dy krahë (P). Njerëzit filluan të punojnë (P). Duke punuar, plotësuan mungesat e mëdha (P). Ndërtuan shtëpi për vete (P). Zbutën kafshët (P). Mbollën tokën (P). Bënë mjete udhëtimi (P). Po ka edhe shumë të tjera që duhen bërë (P). Prandaj të përveshim krahët (P). Ka punë për të gjithë (P).

2. Zana nuk shkoi në shtëpinë e Lirisë.
Ajo nuk u takua me shoqet e saj.
Ajo nuk e la vetëm vëllanë e vogël.
Prindërit e saj nuk u vonuan shumë.

3. Nuk ishte një ditë bukur.
Në qiell nuk doli dielli.
Fëmijët dolën për të luajtur.
Pse dolën fëmijët për të luajtur?
Fëmijët ishin kënaqur.
Ata ishin me prindër.

4. Te hyrja nuk u grumbulluan shumë njerëz.
Nuk kishin ardhur shumë prindër.
Andi nuk recitoi i pari.
Në kor nuk kishte shumë vajza.
Skeçi nuk filloi pas këngës së dytë.
Shfaqja nuk pati sukses.

5. Nuk duhet të shkojmë në shfaqje me vonesë.
Fëmijët duhet të ulen secili në vendin e vet.
Filmi nuk shihet mirë në rreshtin e parë.
Kur nuk mbahet qetësi, fjalët e aktorëve nuk dëgjohej.
Shikuesit duartrokasën shfaqjen e bukur.
Një shfaqje e përgatitur pa kujdes nuk ka sukses.

Zanoret dhe bashkëtingëlloret

1. Në/ fshat/ po /qa/nte /një fë/mi/jë /
Kë/të/ le/pu/ri/ s' desh/ ta/dë/gjo/nte/
Ndaj/ ve/shët i /pa/lon/te...
Në/ fshat /po /qe/shte/ një/ fë/mi/jë/
Kë/të/ le/pu/ri/ desh/ ta/ dë/gjon/te
I/ lu/mtur/ ve/shët/ i/ ço/nte.../

2. a) ë, a, o, e, e, ë, ë, i
b) n, f, sh, p, q, sh, t, nj, f, m, j
3. a. ë, e, e, e, ë, ë, e, e
b. dh, gj, dh, gj, j, j, nj, një; nj, nj, nj, nj
a) zanore
b) bashkëtingëllore

- | | | |
|----|--|--|
| 4. | shëmbull
pamëndë
dhën
e enjte
dhelpëra
aklli
uthlla
lepri | brryl
gjithëçka
kurgjë
vegëla
bulmet
fryta
byfe |
| 5. | çfryj
anie
fëmi
lagjja
paqa
depua
brijë | shkrojë
të rinj
të zij
ftonj
i rallë
karige
xero |
6. prindërit, shkuam, autobus, dardha, molla, pyll, derr, derrat, gjellë

Ndarja e fjalëve në fund të rreshtit

2. lule, të bukura, fluturonin, flutura, dielli, qielli, bubullimat, borës, faleminderit, vallëzonin
3. bre-dhi, lak-ra, e di-el, mu-aj, he-ku-ru-dha, li-ri-a
- | | | | |
|----|--|---|--|
| 4. | li-braria
më-suesja
pri-ndërit
shkrim-tarët
ga-zetarët
avi-atorët
udhë-tarët | libra-ria
mësu-esja
prindë-rit
shkrimta-rët
gaze-tarët
avia-torët
udhëta- rët | mësues-ja

gazeta-rët
aviator-rët |
|----|--|---|--|

Shkruajmë letra dhe kartolina

1. koka, përshëndetja, përmbajtja, mbyllja, nënshkrimi.
rruga, numri, vendi
emri i dërguesit
- | | | |
|----|---|--|
| 3. | I dashur Bardhosh, Të uroj
nga zemra Vitin e Ri.
Shëndet dhe suksese në mësim.
Iliri | Merr Bardhosh Anamali
Rruga "Liria" 25, 74500,
Ulqin |
|----|---|--|
4. a. mbyllja, dërguesi
b. adresa
c. marrësi

Emrat e rrugëve dhe të shesheve

1. rruga "Boshko Strugar"
"Rruga e Petrovcit"
rruga "Kongresi i Berlinit"
bulevardi "Dëshmorët e Kombit"
shetitorja "Republika"
sheshi "Nikolla i Parë"
"Sheshi i Pavarësisë"
sheshi "Skënderbej"

4) Rruga e Cetinjës ose Rruga e Petrovcit janë të mbushura me gjelbërim; rruga “Mark Milani” ka plot rrape e pisha; rrua “Ivan Vujosheviq” dhe rruga “Petar Petroviq Njegosh” sapo janë zgjeruar e asfaltuar sërishmi. Një bukuri të veçantë ka sheshi “Republika”.

Shkrimi i datave

1. 28. 11. 2008
28. XI. 2008
28 nëntor 2008
2. c. koha

Mbiemrat

1. i thellë, i dobët, i kthjelltë, fisnike, i ashpër, blu, guximtare
2. e kaltër, e zezë, të kuqe, të çuditshme, e trashë, të hollë
3.

Mbiemra	Të nyjshëm	Të panyjshëm
i hijshëm	+	
të fuqishëm	+	
të madhe	+	
fisnik		+
madhështor		+
të zinj	+	
të gjatë	+	
të dendur	+	

4. i dashur; i lagur; i vogël; i dashur.
6.

Emrat	Mbiemrat e nyjshëm	Mbiemrat e panyjshëm
Ardiani	i vogël	
vëllanë	e madh	
bar	të gjelbër	
deti	i kaltër	
vapor	i madh	
qytetin	e vogël	bregdetar
qytetin		
rrugët	e gjera	
makina	të ndryshme	
pallate	të reja	shumëkatëshe
pallate		

Foljet

1. është, nxirret, është, përdoret, ka, janë, gërvishten, ka, prodhohen, përdoret

2.

Veprime	Gjendje	Dukuri të natyrës
eci,ngjitem,punoj,hidhem, zbardh,ha,ngrihem,lahem, dal	jam,gjendem, fle, lodhem,gëzohem, rri	ngryset,erret, zbardh

3.

Emra	Folje	Veprime	Gjendje	Dukuri të natyrës
flutur	fluturoj	+		
lajm	lajmëroj	+		
besë	besoj		+	
mend	mendoj		+	
urdhër	urdhëroj	+		
sharrë	sharroj	+		
vesë	veson			+

4. ndjekin; dëgjojmë; bisedojnë; dalin.

5. mbulojnë, jetojnë, ndodhet, quhet, është, ka qenë, prenë, ishte.

Nuk, s' + FOLJE

1. Pohore :

Është dashur punë e madhe për ta bërë të banueshme.

Doje të uleshe. Mungonte kusia e zjarri për të gatuar. Mungonte edhe vetë buka. Ishin vetëm njerëzit me dy krahë. Njerëzit filluan të punojnë. Duke punuar, plotësuan mungesat e mëdha. Ndërtuan shtëpi për vete. Zbutën kafshët. Mbollën tokën. Bënë mjete udhëtimi. Po ka edhe shumë të tjera që duhen bërë. Prandaj të përveshim krahët. Ka punë për të gjithë.

Mohore :

Në fillim Toka nuk ka qenë si sot. S'kishte ura për të kapërcyer lumenjtë. S'kishte rrugë për t'u ngjitur në mal. S'kishte as stol, as karrige. S'kishte shtrat të flije. Nuk kishte as këpucë, as çizme. Nuk gjeje syze askund për sytë. S'kishte top që të luaje. S'kishte gjë prej gjëje.

2. Goni është i pasjellshëm. (pohore)

Goni nuk është i sjellshëm. (mohore)

Koha e leximit është e pakufizuar. (pohore)

Koha e leximit nuk është e kufizuar. (mohore)

Mendimi i tij është padrejtë. (pohore)

Mendimi i tij nuk është i drejtë. (mohore)

Shtëpia është e papërshtatshme. (pohore)

Shtëpia nuk është e papërshtatshme. (mohore)

Përemrat vetorë

1.

Përemra vetorë	njëjës	shumës
Veta e parë	unë	ne
Veta e dytë	ti	ju
Veta e tretë	ai/ajo	ata/ato

2. unë, ajo, ata, ju, ne,

3. ata, ai, ato, ne, ato, ato, ne

Zanatet ose mjeshtëritë

2. a. ar, argjend, bronz, bakër, tel, pëlhurë, stof, pe, kadife, mëndafsh

b. limë, darë, sharrë, brisk, furçë, mashë, sitë, daltë, kudhër, çekiç, gërshërë, gjilpërë, makinë

c. vizatorj, shkrij, pres, qep, skalit, rrah, laj, shqep, derdh, gdhend, vendos, ngjit

Kryefjala

1. Ana, rrobaqepësja, ajo, vajza, përparësja, Ana, shoqet

2. qeni, zogu, uji, macja, lopa, delja

3. Petriti, ajo, mjeku, Mira, disa nxënës, prindërit, ajo, ata

4. vëllai dhe motra; Fatmira, Lola dhe Blerta; djemtë dhe vajzat; mësuesit dhe mësueset

Kallëzuesi

1. a. Alma, gjyshi, motrat, zogjtë, dielli, era

b. Shtron, lexon, shfletojnë, cicërojnë, shkëlqen, fryn

2. leh, pëllet, kakaris, këndon, hungëron, krakëllijnë

3. ka, shikon, dha, mban, tallin, flasin, folën, tallen

4. Kryefjalët: autobusi, Agroni, shoferi, ai, pasagjerët, ora Kallëzuesit : niset, shkon, kontrollon, ka varur, presin, ka shkuar

5. janë nxënës – me folje + emër

janë të mira – me folje + mbiemër

luajnë – me folje

shikojnë – me folje

Fjala e zgjeruar

1. a; b; b; a; b; a; b; b;

2. Ajo doli. Vajzat përshëndeten. Berti vrapoi. Ai vrapoi. Të gjithë shëtiten.

Emërtimet e festave

1. a. kombëtare; b. ndërkombëtare; c. fetare.

3. Viti i Ri; Dita e Pavarësisë; Dita Ndërkombëtare e Grave; 8 Marsi;

1 Qershori; bajrami; kërshëndellat; krishtlindjet;

1.

Festa e Viti të Ri
Dita e Fëmijëve
nevruzi
1 Maji ose Një Maji
Dita e Pavarësisë
krishtlindjet
bajrami i vogël
pashkët katolike

Zanorja ë dhe bashkëtingëlloret *ll, dh*

1. a. femërore

- | | | |
|-------------|--------------|-------------|
| b. një punë | një ndërtesë | një rërë |
| një këngë | një shkollë | një karrocë |
| një ditë | një rrugë | një sharrë |
| një natë | një klasë | një dërrasë |

2. a. luga, arra, tryeza, llamba, dardha, pjeshka

b. një lugë, një arrë, një llambë, një dardhë, një pjeshkë

3. Ishte natë pa hënë . Frynte erë e binte borë . Një vajzë ishte shumë e sëmurë. Piloti i helikopterit kërkonte një fushë ku të ulej. Më në fund ai pa një dritë. Pas pak, vajzës së vogël i erdhi në ndihmë mjeku.

4. dhëmb, dhelpër, ulli, fyell, kërmill

5. i dhashë, llaç-i, llafazan-i, llom-i, dhomë-a, i madh, llapë-a, mulli-ri, kumbull-a

Çfarë është gjuha?

1. a. se ka kaluar dikush; b. se është dimër; c. se ka ndodhur një aksident.

2. a. se vrapuesit duhet të nisen; b. miratim; c. mosmiratim.

3. mjet; rregulla; b. e shkruar

Gjuha amtare

1. shqipja; malazishtja; Shqipëri, Kosovë, Mal të Zi, Greqi; "Meshari"

Kuptimet e fjalës

1. a. çerdhe zogjsh; b. çerdhe fëmijësh.


2. letër shkrimi; letër e porositur; çelësi i derës; çelësi i dritës;

3. faqe e fyturës; faqe e gazetës; yll që ndrit në qiell;
yll me pesë cepa, figurë.

Gjuhët e huaja

1. populli, vendi; gjuhë e huaj; frëngjishtja, rusishtja, spanjishtja, italishtja

5.



6. 1. dallim; 2. kureshtar; 3. u dha; 4. zmadhojë; 5. ngul këmbë.

CIP – Каталогизација у публикацији
Централна народна библиотека Црне Горе, Цетиње

371.3:811.18 (035)

BEI, Bahri

Flasim dhe hartojmë njohim gjuhën: gjuha shqipe 4: për klasën e katërt të shkollës fillore nëntëvjeçare: libri i mësuesit/Bahri Beci; – (ilustrimi Simon Vučković). – Podgoricë: Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore, 2008 (Podgorica: Studio Mouse). – 60 str.: ilustr.; 29 cm

Tiraž 50.

ISBN 978–86–303–1320–2 (broš.)

a) Албански језик - Настава - Методика - Приручници

COBISS.CG-ID 12994064